

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I EDUKIMIT

PROGRAMI MASTER: MASTER I EDUKIMIT INKLUZIV



TEZA MASTER

TEMA: Vështirësitë emocionale dhe arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor

Mentorja:

Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli

Kandidatja:

Ardora Haskuka

Prishtinë, 2022

© [2021]-[Ardora Haskuka] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

ABSTRAKTI

Problem aktual i procesit të mësimdhënies, përveç tjerash janë edhe vështirësitë emocionale të fëmijëve. Studime e hulumtime të shumta të shtjelluara në kapitullin e dytë, tregojnë për një lidhje negative mes vështirësive emocionale dhe arritjeve akademike të fëmijëve, pikërisht këtu qëndron edhe rëndësia e punimit, të sjell një pasqyrë të ndikimit të këtyre vështirësive emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të moshës shkollore. Synimi i këtij hulumtimi është matja/njohja e nivelit të vështirësive emocionale të fëmijëve të moshës shkollore si dhe analizimi i ndikimit të tyre në performancën akademike.

Grupi i synuar i këtij hulumtimi relevant dhe eksplorues, i përbërë nga 113 mësimdhënës të shkollave fillore të Komunës së Prizrenit, i është nënshtruar instrumentit për vlerësim, përkatësisht pyetësorit të Vështirësive dhe Fuqive – SDQ (Goodman, 1997), ku të dhënat e mbledhura dhe paraqitja statistikore e tyre është bërë përmes programit SPSS. Karakteristikat e gjithë hulumtimit përcaktohen në detaje në kapitullin e tretë dhe të katërt që i takojnë metodologjisë së punës dhe analizës së të dhënave. Të gjeturat, sipas analizës empirike në kapitullin e pestë, tregojnë se vështirësitë emocionale ndikojnë në masë të madhe në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e Komunës së Prizrenit. Në anën tjetër, analizat indikojnë se nuk ekziston asnjë dallim statistikiqisht signifikant në mes të fëmijëve të gjinisë mashkullore dhe femërore në raport me vështirësitë emocionale. Gjithashtu, mësimdhënësit meshkuj edhe femra kanë të njëjta mendime sa i përket nivelit të vështirësive dhe ndikimit që kanë këto tek arritjet akademike të fëmijëve. Përfundimisht pa dyshim janë dhënë rekomandime autoriteteve arsimore dhe profesionistëve nga fusha e edukimit që të ndërhyrë për praninë e këtyre vështirësive në shkolla, të nxisin dhe të krijojnë programe ndërhyrëse psikologjike në sistemin arsimor me qëllim të përmirësimit të performancës akademike.

Fjalët kyçe: *Arritje akademike, emocion, ndikim, nxënësit, vështirësi emocionale.*

ABSTRACT

The current problem of the teaching process, among others, is the emotional difficulties of children. Numerous studies and researches elaborated in the second chapter show a negative connection between emotional difficulties and academic achievements of children, this is where exactly the importance of the work lies, to bring an overview of the impact of these emotional difficulties on the academic achievements of children of the school age. The aim of this research is to measure / recognize the level of emotional difficulties of school-age children and to analyze their impact on academic performance.

The target group of this relevant and exploratory research, consisting of 113 primary school teachers in the Municipality of Prizren, was subjected to the assessment tool, respectively the questionnaire of Difficulties and Strengths - SDQ (Goodman, 1997), where the collected data and their statistical presentation were done through the SPSS program. The characteristics of the whole research are defined in detail in the third and fourth chapters that belong in the working methodology and data analysis. The findings, according to the empirical analysis in the fifth chapter, show that emotional difficulties greatly affect the academic achievements of primary school children in the schools of the Municipality of Prizren. On the other hand, the analyzes indicate that there is no statistically significant difference between male and female children in relation to emotional difficulties. Also, male and female teachers have the same views regarding the level of difficulties and the impact they have on children's academic achievements. Finally, without a doubt, recommendations have been given to educational authorities and professionals in the field of education to raise awareness of the presence of these difficulties in schools, to promote and create psychological intervention programs in the education system in order to improve academic performance.

Keywords: *Academic achievement, emotion, influence, students, emotional difficulty.*

DEDIKIMI

Familjes sime, ju jeni porti im i ngrohtë i strehimit, motivimi im përgjatë rrugës!

FALËNDERIMI

Me shumë kënaqësi do të doja të shprehja falënderimet e mia të sinqerta për të gjithë ata që më ndihmuan, konsultuan dhe më mbështetën moralisht gjatë realizimit të kësaj teme. Gjej rastin të shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë stafin e Universitetit të Prishtinës, që me punën e tyre të përkushtuar na ndihmuan në plotësimin dhe arritjen e qëllimeve tona.

Një falënderim i veçantë i kushtohet mentores sime Prof. ass. dr. Ardita Devolli, për mbështetjen e inkurajimin e vazhdueshëm si dhe për komentet e idetë e çmuara të cilat e kanë shoqëruar këtë punim që në ngjizje e deri në formën e tij përfundimtare. Falënderoj komisionin për vlerësimin e temës sime të masterit, Prof. asoc. dr. Naser Zabeli dhe Prof. ass. dr. Majlinda Gjelij. Falënderime për të gjithë mësuesit/set që morën pjesë në plotësimin e pyetësorit dhe realizimin e hulumtimit tim. Një mirënjohje e thellë shkon për të gjithë plejadën e mësuesve, njerëzve të mi më të afërt mes të cilëve mësues të merituar dhe doktor shkencash që kanë qenë dhe janë për mua një frymëzim i pashtershëm.

Nuk duhen harruar edhe miqtë dhe kolegët, ata që më dhanë mbështetje dhe përkrahje në çdo sfidë dhe mbi të gjitha ata që i dhanë hijeshi viteve të studimit, në veçanti miket e mia të studimeve Mjellma Shala dhe Suada Kryeziu.

Dhe në fund, por jo më pak të rëndësishme janë falënderimet që shkojnë për familjen time për sakrificën, mbështetjen, besimin, ndihmesën si dhe dashurinë e tyre të pakursyer. Engjëlli që më shikon nga lart, gjysh, ndonëse në momentet e fundit të jetës, gjete forcë dhe nuk ndalove asnjëherë së përkrahuri mbesën tënde, të falënderoj pafund. Shumë i dashur babi, urtësia e dashuria e madhe që di të fal më inkurajuan vazhdimisht të ec përpara e të arrij suksese, e shtrenjta nënë, të vlefshmit e mi Agron e Esra, ju jam mirënjohëse e ju dua pafund!

Ju falënderoj nga thellësia e zemrës!

PËRMBAJTJA

I. HYRJE.....	1
Qëllimi i hulumtimit.....	1
Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza	2
II. SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
Emocionet.....	3
Emocioni dhe gjinia.....	5
Vështirësitë emocionale	6
Ankthi	7
Frika.....	8
Depresioni.....	11
Turpi	13
Ndrojtja.....	14
Performanca akademike	14
Faktorët që ndikojnë në performancën akademike.....	15
Studime lidhur me ndikimin e vështirësive emocionale në performancën akademike	17
III. METODOLOGJIA	19
Mostra e hulumtimit	19
Instrumentet e hulumtimit	20
Procedura e hulumtimit	21
IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET	22

Testimi i hipotezave	41
Testimi i hipotezës së parë	42
Testimi i hipotezës së dytë	43
Testimi i hipotezës së tretë	47
Rezultatet e testimit të hipotezave.....	48
V. DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET	49
Kufizimet e studimet	52
Hulumtimet në të ardhmen	53
Implikimet praktike nga studimi	54
VI. BIBLIOGRAFIA	55
SHTOJCA: PYETËSORI	60

Lista e tabelave

Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës	20
Tabela 2. Respodentët sipas institucionit.....	23
Tabela 3. Respodentët sipas lokacionit.....	24
Tabela 4. Mosha e fëmijëve	24
Tabela 5. Gjinia e fëmijës	25
Tabela 6. Mosha e mësimitdhënësve	25
Tabela 7. Gjinia e mësimitdhënësve	25
Tabela 8. Paraqitja e nivelit të shkollimit të respodentëve	26
Tabela 9. Respodentët sipas përvojës në arsim.....	26
Tabela 10. I merr në konsideratë ndjenjat e të tjerëve	27
Tabela 11. Nervoz, tepër aktiv s'mund të qëndrojë në një vend për kohë të gjatë	27
Tabela 12. Shpesh ankohet për kokëdhimbje, dhimbje barku ose për sëmundje	28
Tabela 13. Me lehtësi i ndan me fëmijë të tjerë, p.sh. lojërat, ushqimin	28
Tabela 14. Shpesh e humbet temperamentin (disponimin).....	29
Tabela 15. Preferon më tepër të rri vet se me fëmijët tjerë.....	29
Tabela 16. Në përgjithësi sillet mirë, zakonisht bën atë që ia kërkojnë të rriturit	29
Tabela 17. Shumë shqetësime ose shpesh duket i shqetësuar.....	30
Tabela 18. Dobishëm (ndihmues) nëse dikush lëndohet, mërzitët ose ndjehet i sëmurë.....	30
Tabela 19. Vazhdimisht luhatet ose bën lëvizje nervozizmi.....	31

Tabela 20. Ka së paku një shokë të mirë	31
Tabela 21. Shpesh grindet me fëmijët tjerë ose i ngacmon ata.....	32
Tabela 22. Shpesh është i trishtuar, i dëshpëruar ose i përlotur.....	32
Tabela 23. Në përgjithësi, fëmijët tjerë e duan atë	33
Tabela 24. Hutohet me lehtësi, humbet përqendrimin.....	33
Tabela 25. Nervoz në situatë të re, lehtë humbet besimin	34
Tabela 26. I sjellshëm me fëmijët më të rinj.....	34
Tabela 27. Shpesh gënjen ose mashtron	35
Tabela 28. Bie në sy ose ngacmohet nga fëmijët tjerë.....	35
Tabela 29. Shpesh u ofron ndihmë te tjerëve (prindërve, mësuesve, fëmijëve)	36
Tabela 30. I mendon gjërat para se të veprojë	36
Tabela 31. Vjedh prej shtëpisë, shkollës ose gjetkë.....	36
Tabela 32. Kalon më mirë me të rriturit se me fëmijët e tjerë	37
Tabela 33. Frikësohet lehtë	37
Tabela 34. Ka vëmendje të plotë, ose përfundon detyrat deri në fund	38
Tabela 35. Sa gjatë i ka pasur këto vështirësi	38
Tabela 36. A e mërzisin apo e shqetësojnë vështirësitë atë	39
Tabela 37. Ndërlidhja e vështirësive me jetën e përditshme të fëmijës në raportet kolegiale	39
Tabela 38. Ndërlidhja e vështirësive me jetën e përditshme të fëmijës në të mësuarit në klasë ..	40
Tabela 39. A i vënë ngarkesë këto vështirësi klasës në tërësi	40

Tabela 40. Testi i korrelacionit Pearson për hipotezën e parë	42
Tabela 41. Testi H_i^2 për hipotezën e dytë	44
Tabela 42. Mesatarja e nivelit të vështirësive tek gjinia femërore dhe mashkullore	47
Tabela 43. Testi i rëndësisë statistikore (Independent Sample Test) për hipotezën e tretë	48

Lista e figurave

Figura 1. Lidhja në mes të vështirësive emocionale dhe pengesave në arritjet akademike.....	43
Figura 2. Krahasimi gjinor në deklaratën “A e mërzhisin apo shqetësojnë vështirësitë atë?”	45
Figura 3. Krahasimi gjinor mbi ndikimin e vështirësive në raportet kolegjiale	45
Figura 4. Krahasimi gjinor mbi ndikimin e vështirësive në të mësuarit në klasë.....	46
Figura 5. Krahasimi gjinor i mësimeve lidhur me ndikimin e vështirësive klasës në tërësi	46

I. HYRJE

Në Kosovë vitet e fundit ka filluar të rritet vëmendja ndaj vështirësive të fëmijëve e veçanërisht të atyre emocionale si dhe ndikimin e tyre në shoqëri. Sipas Institutit Kombëtar të Shëndetit Mendor - NIMH, çrregullimet emocionale dhe të sjelljes ndikojnë në 10-15% të fëmijëve globalisht, e duke u nisur nga këto rezultate, përvoja e cekët në këtë drejtim si dhe dëshira për të vërtetuar ndikimin e këtyre vështirësive në performancën akademike të fëmijëve në vendin tim, jam përpjekur që të hedhë në dritë këtë ndikim dhe tu hap rrugë edhe hulumtimeve tjera (Morris & Maisto, 2008).

Arritjet akademike përfaqësojnë një nga variablat më të studiuara. Studimet kanë treguar se të rinjtë me probleme të shëndetit mendor kanë arritje më të ulëta akademike, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre (McLeod, Uemura, & Rohrman, 2012). Ka evidenca të fuqishme se vështirësitë emocionale janë të lidhura me vështirësitë akademike (Arnold, 1997) dhe (Hinshaw, 1992), me ç'rast ndodhin edhe raste të shumta të braktisjes së shkollimit, dështimit akademik dhe abuzimit me substanca, e natyrisht këto prekin jo vetëm individin por edhe shoqërinë.

Ky studim shkencor ka për synim të evidentojë ndikimin e vështirësive emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor. Studimi thekson njohjen me nivelin e vështirësisë emocionale të fëmijëve nga ana e mësimdhënësve dhe rolin e tyre në trajtimin e nxënësve me prezencë të vështirësisë emocionale duke ndihmuar fëmijët të përmirësojnë performancën akademike dhe të lehtësojnë shprehjen e simptomave tek nxënësit. Hulumtimi merr përsipër që të analizojë në mënyrë të thelluar vështirësitë emocionale, si dhe të zbulojë shkallën e ndikimit të këtyre vështirësive në arritjet akademike të fëmijëve, që paraqet qëllimin kryesor të këtij hulumtimi.

Qëllimi i hulumtimit

Ky studim shkencor ka pasur për synim të evidentojë ndikimin e vështirësive emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor. Studimi thekson njohjen me nivelin e vështirësisë emocionale të fëmijëve nga ana e mësimdhënësve dhe rolin e tyre në trajtimin e nxënësve me prezencë të vështirësisë emocionale, duke ndihmuar fëmijët të përmirësojnë performancën akademike (të lexuarin, të kuptuarin, zgjidhjen e ushtrimeve) dhe të lehtësojnë

shprehjen e simptomave tek nxënësit. Gjithashtu punimi ka analizuar raportet mes këtyre vështirësive dhe arritjeve akademike, gjinisë, moshës dhe arritjeve akademike.

Pyetjet e hulumtimit dhe hipoteza

Në vijim, në përmbushje të qëllimeve të këtij hulumtimi, do t'i shtjellojmë pyetjet kryesore kërkimore, të cilave u përpiqet t'u jap përgjigje ky hulumtim:

1. Sa ndikojnë vështirësitë emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e ulëta të Komunës së Prizrenit?
2. Sa janë të përgatitur mësime dhënësit për vështirësitë emocionale të fëmijëve të ciklit fillor?
3. Cila gjini është më e prirë të ketë vështirësi emocionale?

Duke u bazuar në pyetjet e hulumtimit, parashtrua tri hipoteza:

H1 - Vështirësitë emocionale ndikojnë në masë të madhe në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e Komunës së Prizrenit.

H2- Mësime dhënësit nuk janë të përgatitur mjaftueshëm për njohuritë e vështirësive emocionale të fëmijëve të ciklit fillor.

H3-Gjinia femërore është më e prirë të ketë vështirësi emocionale, krahasuar me gjininë mashkullore.

Kapitulli I, dha një pasqyrë të situatës aktuale në Kosovë dhe një arsyetim për kryerjen e këtij studimi. Ky kapitull përfundon me paraqitjen e pyetjeve kërkimore dhe hipotezave të parashtruara të studimit. Në kapitullin II, janë paraqitur kontributet teorike e praktike të ofruara nga studiues e kërkues të huaj e vendas për konceptet themelore, vështirësitë emocionale dhe arritjet akademike. Në Kapitullin III, përshkruhet metodologjia e hulumtimit duke përfshirë karakteristikat e mostrës, instrumentet, metodat e mbledhjes së të dhënave dhe qasja ndaj analizës. Kapitulli IV paraqet në detaje gjetjet e studimit, për të vazhduar më tej me kapitullin V, ku diskutohen gjetjet, konkludimet kyçe, shtjellohen kufizimet e studimit, jepen udhëzimet për hulumtimet në të ardhmen, si dhe implikimet praktike nga studimi.

II. SHQYRTIMI I LITERATURËS

Emocionet

“Vetëm përmes zemrës mund të shohim qartë; Gjërat më të rëndësishme nuk shihen dot me sy.”

Antoine De Saint-Exupery, Princi i vogël

Për ruajtjen e jetës dhe vazhdimësinë e normalitetit në aktivitetin e qenies njerëzore, ndjenjat dhe emocionet janë të një rëndësie të madhe. Kontrollimi i duhur i gjendjeve emocionale na mundëson t’u bëjmë ballë problemeve, sidomos në raste të veçanta. Emocionet dhe ndjenjat janë një lloj komunikimi specifik. Mund të themi se emocionet janë gjuha jonë e parë, pasi që edhe jeta e qenies njerëzore fillon me aktin e të qarit, duke komunikuar kështu emocionalisht me botën përreth. Njerëzit që janë në gjendje t’i kuptojnë ndjenjat e tyre, arrijnë ta drejtojnë më mirë jetën e tyre. Ekzistojnë përkufizime të shumta për emocionin nga autorë të ndryshëm, e në vazhdim do të trajtohen disa prej tyre për të qartësuar më tej këtë term.

Përkufizimi i emocionit në Oxford Dictionary është “Një ndjenjë e fortë që vjen nga rrethanat, gjendja ose marrëdhëniet e dikujt me të tjerët” (Simpson & Weiner, 1989). Emocionet janë përgjigje ndaj ngjarjeve të rëndësishme të brendshme dhe të jashtme.

Psikologjia bashkëkohore emocionet i konsideron gjendje e ndjenjave të ndërlikuara, madje edhe sjellje të ndërlikuara, që mbështeten në ndryshime të disa sistemeve organike. Kështu, në fjalorin çelësor të psikologjisë të botuar para dhjetë vitesh, thuhet: “Emocioni në nivelin fiziologjik është proces trupor, që përfshin fluktime të mprehta, kur njeriu është në gjendje të shqetësimit. Këto ndryshime manifestohen në rrahje të zemrës, në frymëmarrje, në tajim të hormoneve të gjëndrave, etj. Në nivelin psikologjik, emocioni përjetohet si reagim shumë i këndshëm ose shumë i pakëndshëm, të cilit ia shtojmë fjalët përshkruese, sikurse është hidhërimi” (Nushi, 2002).

Që në vitin 1884, James (James, 1884), argumentoi se emocioni është ndjenja e ndryshimeve trupore që ndodhin si reagim ndaj ngjarjeve ekzistuese të mjedisit.

Ndërsa Freud, në vitin 1915, deklaroi se emocionet ishin shkarkime fiziologjike të cilat shfaqen në formën e ndjenjave (Freud, 1915).

Sipas teorisë së Xhejms-Langes, nxitësit mjedisorë mund të shkaktojnë ndryshime psikologjike dhe pastaj, kur jemi të vetëdijshëm për këto ndryshime, lindin emocionet. Ndryshe prej saj, teoria e Kanon-Bardit pohon se emocionet dhe reagimet trupore ndodhin njëkohësisht. Një pikëpamje tjetër është, teoria konjitive e emocionit, këmbëngul se perceptimet dhe gjykimet tona mbi situatat janë kryesore për përjetimet tona emocionale. Pa këto konjicione ne nuk do ta kishim idenë si t'i etiketonim ndjenjat tona. Gjithsesi, me këtë pikëpamje nuk bien dakord të gjithë, sikur C. E. Izardi, i cili argumenton se shprehje të caktuara, të lindura, të fytyrës dhe pozicioneve të trupit shkaktohen automatikisht nga situata që lindin emocione, që pastaj "lexohen" nga truri si ndjenja të veçanta (Morris & Maisto, 2008).

Davitz (Davitz, 1969), ngre teorinë për të përshkruar emocionet, duke e lidhur këtë me 6 nivele apo shtresime që mund të bëhen rreth kuptimeve për emocionin:

1. Emocionet lidhen me shumë ngjarje të përjetuara dhe që janë personale.
2. Emocionet përbëhen nga gjendja specifike ku secila prej tyre mund të etiketohet sipas përvojës personale.
3. Gjuha e emocioneve reflekton eksperiencat, por edhe eksperiencat emotive influencohen nga faktorët lingvistikë.
4. Përcaktimi i gjendjes emocionale duhet parë i lidhur ngushtë me dimensionin e çdo eksperience emotive dhe se kjo e fundit bazohet tek aktivizimi i individit.
5. Etiketimi i çdo emocioni varet nga eksperiencia emotive dhe se ndryshimi i eksperiencës sjell ndryshime në etiketim.
6. Gjendjet emocionale vijnë prej stimujve që lidhen me dimensionin e situatës ku zhvillohet një ngjarje specifike.

Psikologu amerikan (Izard, 1993), në librin e tij "Face of Emotion", arriti të formulojë disa piketa bazë, që përshkruajnë çdo teori të emocionit. Ato janë:

- Çdo sistem emocional tek individit është i motivuar dhe çdo emocion që lind, mund t'i atribuohet një shkak që qëndron tek individit ose jashtë tij.

- Emocionet shoqërojnë njohjen në përgjithësi dhe se emocione të veçanta marrin pjesë në mënyrë aktive për organizimin e perceptimeve, të sjelljes dhe sidomos në veprimtarinë krijuese të individit.
- Lidhja mes emocioneve dhe sjelljes njerëzore zhvillohet qysh herët. Gjatë procesit të rritjes së individit në moshë ajo mbetet disi konstante deri sa spektri i reagimeve specifike të zhvillohej.
- Zhvillimi emocional kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm të personalitetit të çdo individi.

Fillimi i veprimit të çdo emocioni që përjetohet dhe zhvillimi i eksperiencave emocionale kushtëzohet nga natyra e çdo individi, nga diferencat individuale dhe nga veçoritë e personalitetit (Orhani, 2011).

Ne, si individ shpesh dëgjojmë të thuhet se pa emocione, jeta dhe aktiviteti njerëzor nuk do të kishin kuptim. Ndonëse, besohet se kjo është e vërtetë, ne nuk mund të përcaktojmë me saktësi emocionet që përjetojmë pasi që ekzistojnë një numër i madh i emocioneve dhe u përkasin llojeve të ndryshme. Prandaj studiues e psikolog të shumtë, kanë bërë klasifikime të emocioneve duke u bazuar në kritere specifike e këndvështrimet e tyre. Një prej klasifikimeve që vlen të përmendet, është ai në bazë të natyrës së tyre, me ç'rast emocionet grupohen në tre grupe të mëdha:

- a) *Emocionet bazike* – të cilat janë të lindura dhe universal, përjetoohen njëjloj nga të gjitha qeniet njerëzore dhe kanë të njëjtën formë të shprehjes së tyre.
- b) *Emocionet specifike kulturore* – formohen vetëm në kontekst kulturor, pasi janë kryesisht të mësuara dhe i kanë rrënjët në kulturën, traditat dhe normat e asaj shoqërie ku zbatohen.
- c) *Emocione të larta kognitive* – janë pjesë e natyrës së qenies njerëzore dhe janë të lindura me pjesëmarrjen e neokorteksit, që është pjesa më e zhvilluar e trurit (Orhani, 2011).

Emocioni dhe gjinia

Studimet hedhin po ashtu një farë drite mbi çështjen se a janë femrat apo meshkujt më pak emocional. Në një studim, kur meshkujt dhe femrat panë vizatime të njerëzve të shqetësuar,

meshkujt shprehën më pak emocion, kurse femrat shprehën ndjenja shqetësimi (Eisenberg & Lennon, 1983). Gjithsesi, matja psikologjike e nxitjes emocionale (si rrahja e zemrës apo tensioni i gjakut), tregonte se meshkujt e marrë në studim, në të vërtetë u ndikuan më tepër se femrat. Meshkujt thjesht e frenuan shprehjen e emocioneve të tyre, ndërsa femrat ishin më të hapura në ndjenjat e tyre. Këtë konkludim e mbështesin edhe gjetjet në një studim të ri, të cilët sugjerojnë që kur shikojnë video që shkaktojnë një përgjigje emocionale, meshkujt shpesh kanë përvoja emocionale më intensive, ndërsa gratë kanë ekspresivitet më të lartë emocional, veçanërisht për emocionet negative. Për më tepër, dallimet gjinore varen nga lloji i veçantë i emocioneve, por jo nga valenca (Deng, Chang, Yang, Huo, & Zhou, 2016).

Në një studim që përbën një përmbledhje të plotë meta-analitik të dallimeve gjinore dhe moderatorëve të shprehjes së emocioneve nga foshnjëria deri në adoleshencë, konkludohet që vajzat shfaqin më shumë emocione pozitive dhe emocione të brendshme (p.sh., trishtim, ankth, simpati) sesa djemtë, dhe djemtë tregojnë më shumë emocione të jashtme (p.sh., zemërim) sesa vajzat. Dallimet gjinore në emocionet pozitive ishin më të theksuara me rritjen e moshës, me vajzat që shfaqnin më shumë emocione pozitive sesa djemtë në fëmijërinë e mesme (Chaplin & Aldao, 2013).

Po ashtu, meshkujt dhe femrat ndryshojnë edhe në aftësinë e tyre për të interpretuar sinjalet pa fjalë të emocionit. Femrat dhe vajzat e reja janë më të afta se burrat dhe djemtë e rinj, në zbrëthimin e shprehjeve të fytyrës, sinjaleve trupore dhe timbrit të zërit të të tjerëve (Bosacki & Moore, 2004).

Vështirësitë emocionale

Duke u nisur nga mendimi që kontrollimi i duhur i gjendjeve emocionale na mundëson t'u bëjmë ballë problemeve, sidomos në raste të veçanta si dhe duke e ditur faktin që njerëzit që janë në gjendje t'i kuptojnë ndjenjat e tyre, arrijnë ta drejtojnë më mirë jetën e tyre, shohim se sa e rëndësishme është njohja dhe trajtimi i menjëhershëm i devijimeve të mundshme emocionale.

Sipas Woolfolk (Woolfolk, 2011) çrregullimet emocionale janë emocionet që shmangen a devijojnë kaq shumë nga norma, saqë pengojnë zhvillimin dhe rritjen normale të vetë fëmijës, si dhe ndikojnë në jetën e të tjerëve. Këtu përfshihen depresioni apo mërzitjet, frikërat dhe

ankthet, si dhe paaftësia për të krijuar marrëdhënie me të tjerët. Është e qartë se shmangia nënkupton dallimin nga standardet, të cilat ndryshojnë sipas situatës, grupmoshës, kulturës, prejardhjes etnike dhe periudhës kohore.

Shmangie nuk mund të quhet reagim i përkohshëm ndaj një ngjarjeje stresuese. Shmangie a devijim është ajo që ndodh në mënyrë të vazhduar dhe në situata të ndryshme, edhe pasi mësuesit e klasave normale kanë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme (Forness & Knitzer, 1992).

Në librin e tij “Psikologjia e Emocioneve” (Orhani, 2011), vë në pah se studimet e shumta tregojnë se vargu i çrregullimeve emocionale është shumë i madh. Në këtë vështrim edhe pamundësia e individit për të rregulluar intensitetin e reagimeve, edhe shtypja e emocioneve bëhen shkak për çrregullime emocionale, pasi individi humbet informacionin orientues dhe nuk arrin të adaptohet, në situata të tilla.

Problemet emocionale në fëmijërinë e mëvonshme përfshijnë çrregullime paniku, çrregullim ankthi të përgjithësuar (GAD), ankth ndarje, fobi sociale, depresion.

Ankthi

Ankthi dhe frika janë emocionet primare bazë të qenia njerëzore. Ato janë të lidhura me njëra tjetrën dhe se ende nuk është i qartë dallimi mes tyre. Sipas Frojdit, i pari që u përpoq të bënte dallimin mes ankthit dhe frikës, ankthi lidhet me gjendje psikologjike që nuk shoqërohen e vëmendje të veçantë ndaj objektit frikësues, ndërsa te frika vëmendja është tërësisht e përqendruar në këtë objekt. Ankthi është një ngritje emocionale, një gjendje shqetësimi përgjithësisht e vështirë dhe stresante, e shkaktuar nga pritshmëria e ndonjë stimuli apo situatë që nuk është fizikisht e pranishme dhe realisht e dhimbshme, por parandjehet të jetë e tillë dhe se individi ndodhet nën trusninë e një përjetimi të tillë për një kohë të gjatë. Shfaqja e ndjesisë së ankthit është një problem kompleks. Studiuesit theksojnë se kur njeriu përjeton ankth, ai prirret të shmang praninë e të tjerëve për të ruajtur vetëvlerësimin, pasi prania e të tjerëve dëmton vetimazhin. Prandaj veç kësaj, ankthi është parë prej tyre jo vetëm si shqetësim por edhe

kërcënim i shëndetit të tyre (Orhani, 2011). Shfaqje të përbashkëta të çrregullimeve të ankthit përfshijnë simptoma fizike si shkalla e rritur e zemrës, gulçim, djersitje, dridhje, dhimbje në gjoks, siklet barku dhe neveri. Simptoma të tjera përfshijnë brengat për gjërat para se të ndodhin, shqetësime të vazhdueshme për familjen, shkollën, miqtë ose aktivitetet, mendimet e përsëritura, të padëshiruara (detyrimet) ose veprimet (detyrimet), frikën e sikletit ose gabimet, vetëvlerësimin e ulët dhe mungesën e vetëbesimit.

Efektet e ankthit në arritjet shkollore janë të qarta. Kërkuesit kanë raportuar vazhdimisht bashkëlidhje negative midis pothuajse çdo aspekti të arritjeve në shkollë dhe një game të gjerë nivelesh të ankthit. Analiza e rrugës konfirmoi rëndësinë relative të fenomeneve të ankthit për performancën e testit në klasë në një rrjet kausal të urdhëruar në kohë që përfshin nivelin e aftësisë, efektivitetin e studimit dhe ngjalljen e ankthit. Një ndërveprim tregoi se informacioni i bllokuar më parë u bë i disponueshëm vetëm për ata studentë me ankth të lartë që fillimisht kishin përdorur strategji të efektshme studimi (Covington & Omelich, 1987).

Ankthi mund të jetë edhe shkak, edhe pasojë e dështimit në shkollë – nxënësit kanë ecuri të dobët në mësim, sepse ndjejnë ankth dhe nga ana tjetër, performanca e tyre e dobët e shton ankthin. Ankthi ndoshta është tipar, edhe gjendje. Disa nxënës priren të jenë në ankth në shumë situata (ankthi si tipar), por disa situata janë nxitëse të ankthit (ankthi si gjendje) (Zeidner, 1998).

Vëzhgimet kanë treguar se çrregullimet e ankthit janë më të zakonshme se sa format e tjera të çrregullimeve (Narrow, Rae, Robins, & Rieger, 2002). Çrregullimet e ankthit mund të ndahen në akoma më tej në disa kategori diagnozash, përfshirë fobitë specifike, çrregullimin e panikut dhe çrregullime të tjera të ankthit, si çrregullimi i ankthit të përgjithësuar, çrregullimi fiksues-detyrues dhe çrregullimet e shkaktuara nga ngjarje të veçanta traumatike (Morris & Maisto, 2008).

Frika

Frika është një reaksion normal ndaj një burimi të jashtëm rreziku, i njohur nga vetëdija jonë. Maslow, thekson në hierarkinë e nevojave, nevoja për siguri është një nga nevojat më

themelore është një prej tyre. Njerëzit duan të ndihen të sigurt. Prandaj, ata kanë frikë nga gjërat që nuk i njohin dhe që nuk i dinë. Frika është në përshtatje me burimin e rrezikut, si për sa i përket intensitetit ashtu edhe kohëzgjatjes, dhe shpërndahet kur shkaktari largohet ose shmanget. Frika përfshin ndjenjat subjektive të shqetësimit si dhe të ndryshimit fiziologjik objektiv, në të cilat si rregull futen: rrahjet e shpeshta të zemrës, shpejtimi i frymëmarrjes, dridhjet muskulore dhe rishpërndarja e gjakut nga lëkura dhe organet e brendshme në grupet e muskujve të mëdhenj. Këto ndryshime e përgatisin trupin për veprimtari muskulore violente (“luftim ose fluturim”), që mund të jenë të domosdoshme në përgjigje të kërcënimit.

Frika përkufizohet si një ngritje emocionale që shkaktohet nga pritshmëria e një stimuli të rrezikshëm që është prezent në një situatë konkrete. Kur një njeri përjeton frikë, atëherë tek ai krijohet një situatë e veçantë, e cila në vetvete, përmbledh:

1. Përgatitjen për përballimin e rrezik.
2. Rritje të vëmendjes dhe të tensionit motorik.
3. Veprimin motorik që përcillet me të ikurin me vrap.
4. Pranimi i gjendjes së frikës nga individi (Orhani, 2011).

Frika mund të shfaqet në disa forma të saj, si frika reale, frikë fëmijërore, frikë neurotike ose fobi. Sipas Frojdit (Frojd, 2013), frika fëmijërore ka shumë gjëra të përbashkëta me frikën neurotike, pasi fëmija nuk është në gjendje të kuptojë se kush është rreziku. Ai gjithashtu thekson që frika karakterizohet nga një shenjë fare e qartë e diçkaje të pakëndshme, por me kaq nuk merr fund cilësia e saj: jo çdo gjë që ka karakterin e të pakëndshmes mund ta quajmë frikë.

Psikologu Watson, ka argumentuar përmes teorisë biheiviorale se frikërat përgjithësisht janë të mësuara përmes kushtëzimit klasik, përveç pak frikërave që janë të lindura, si frika nga zhurmat, frika nga errësira dhe mungesa e të tjerëve. Nga përvoja dihet se fëmijët në përgjithësi ndihen më të frikësuar ndaj shumë gjërave, e cila konsiderohet si pjesë e rritjes normale të tyre. Shumë fëmijë ndjejnë frikë dhe ankth në situatë të veçanta në shkollë, p.sh. dita e parë e shkollës. Kur fëmija ndjen frikë, ai mund të bëhet impulsiv ose dhe i hutuar. Ndërsa shenja tjera që mund të paraqiten janë: nervozizmi, gjumi i çrregullt, dhimbjet e kokës, djersitja e duarve e të tjera. Me rritjen e fëmijës një frikë mund të zhduket dhe në vend të saj shfaqet një tjetër. Forma

të frikës që hasen te fëmijët janë: frika nga shkolla, frika nga udhëtimi me autobus, nga thirrja e emrit në klasë, ndërrimi i rrobave për edukatë fizike në ambiente shkollore, ankthi i ndarjes nga prindërit e të tjera (Orhani, 2011).

Kujdestarët, të afërmit e fëmijës së modeluar, njerëzit që ekzistojnë në rrethin shoqëror të tij, mësuesit, jeta shkollore janë të një rëndësie të madhe, në zgjidhjen e ankthit dhe frikës, Që nga fëmijëria, individët mësojnë t'i emërojnë emocionet që ndiejnë me një mënyrë shpërblimi dhe ndëshkimi. Fakti që kujdestarët, të cilët janë përgjegjës për garantimin e sigurisë së tyre dhe rreth tyre, janë të pasigurt dhe jashtëzakonisht në ankth, i bën fëmijët më të frikësuar nga situatat ekzistuese. Si rezultat ankthi i tyre është i rritur; gjithashtu shkakton një rritje të problemeve fiziologjike dhe mendore (Şahin, 2019).

Problemi vështirësohet kur frika dhe ankthi vazhdojnë më gjatë, e kështu kthehet në fobi. Fobia cilësohet si frikë ekstreme nga diçka. Personi me fobi shfaq simptoma intensive të ankthit, të cilat rriten vazhdimisht.

Fobia specifike - paraqet një çrregullim ankthi që karakterizohet nga frikë e madhe, paralizuese, prej diçkaje. Frika në këtë rast është e tepruar dhe e paarsyeshme, duke e penguar në këtë mënyrë funksionimin e jetës në përgjithësi.

Fobia sociale - paraqet çrregullimin e ankthit që karakterizohet nga frikë e tepruar, e panatyrshme, që lidhet me situatë sociale apo me daljen para njerëzve të tjerë. Këtu futen shumica e fobive të situatave: rreziqet për ndonjë përplasje me tren apo përmbytje, fobia nga vetmia e nga turmat e njerëzve.

Agarofobia - është akoma më ligështuese se sa fobia sociale, përfshin frikë të shumëfishtë, të madhe nga turmat, vendet publike dhe situata të tjera që të veçojnë nga një burim sigurie i tillë si shtëpia. Agarofobia është tipike për moshat e reja dhe më shpesh vihet re tek femrat sesa tek meshkujt (Orhani, 2011). Megjithëse agarofobia është më pak e zakonshme se fobia sociale, për shkak se efektet e saj janë më të këqija, ajo ka më shumë gjasa që ta bëjë vuajtësin të kërkojë trajnim (Smits, O'Clairigh, & Otto, 2006).

Depresioni

Depresioni shpesh ndodh tek fëmijët nën stres, duke përjetuar humbje, ose që kanë vëmendje, mësim, sjellje ose çrregullime ankthi dhe sëmundje të tjera kronike fizike. Simptomat e depresionit janë të larmishme dhe proteane, shpesh duke imituar probleme të tjera, duke përfshirë humor të ulët, trishtim të shpeshtë, lot, ulje interesi ose kënaqësie në pothuajse të gjitha aktivitetet; ose pamundësia për të shijuar aktivitetet e parapëlqyera më parë, mungesa e shpresës, mërzitja e vazhdueshme; energji të ulët, izolim social, komunikim të dobët, vetëbesim dhe ndjesi të ulët, ndjenja e pavlefshmërisë, ndjeshmëri ekstreme ndaj refuzimit ose dështimit, rritje e nervozizëm, shqetësim, zemërim ose armiqësi, vështirësi në marrëdhënie, ankesa të shpeshta të sëmundjeve fizike si dhimbje koke, dhimbje të stomakut, mungesa të shpeshta nga shkolla ose performancë e dobët në shkollë, përqendrim i varfër, një ndryshim i madh në hahet dhe / ose modelet e gjumit, humbje peshe ose fitim kur nuk dihet, flitet për përpjekje për të ikur nga shtëpia, mendimet apo shprehjet e vetëvrasjes ose sjellje vetë shkatërruese (Ogundele, 2018).

Edhe fëmijët dhe adoleshentët mund të vuajnë nga depresioni. Te fëmijët shumë të vegjël, depresioni hera-herës është i vështirë të diagnostikohet, sepse simptomat janë zakonisht të ndryshme nga ato të rriturve. Te foshnjat ose parashkollorët, depresioni mund të shfaqet si “pamundësi zhvillimi” ose për të shtuar në peshë, ose vonesa në të folur apo në zhvillimin motor. Në fëmijët e moshës shkollore, depresioni mund të shfaqet si një sjellje antisociale, shqetësim i tepruar, shqetësime të gjumit ose si lodhje e papërligjur (Morris & Maisto, 2008). Depresioni parashkollor shfaq një kurs kronik gjatë adoleshencës së vonë dhe shoqërohet me tipare temperamentit dhe personaliteti, shëndet më të dobët fizik dhe praktika negative prindërore. Depresioni parashkollor parashikon deficite në adoleshencë, duke përfshirë vështirësi sociale dhe reagim të ashpër nervor ndaj shpërblimeve. Parashkollorët me depresion mund të përjetojnë ide dhe sjellje vetëvrasëse dhe të shfaqin një kuptueshmëri të saktë të finalitetit të vdekjes. Tani është vërtetuar një trajtim për depresionin parashkollor që përdor marrëdhënien prind-fëmijë për të rritur zhvillimin e emocioneve dhe për të zvogëluar simptomat depresive.

Fëmijët me çrregullim të madh depresiv kanë të njëjtat karakteristika thelbësore si adoleshentët dhe të rriturit, duke marrë parasysh kapacitetet e fëmijës për njohje dhe gjuhë, dhe fazën e zhvillimit. Një fillim më i hershëm i sëmundjes shoqërohet me pasojat më të dobëta dhe

me një morbiditet më të madh psikiatrik që vazhdon deri në moshën e rritur. Çrregullimi i madh depresiv është më i zakonshëm se që ishte parashikuar, dhe duhet të konsiderohet për çdo fëmijë që paraqitet me simptoma depresive dhe/ose funksionim psikosocial të dëmtuar (Charles & Fazeli, 2017).

Sipas studimeve, fëmijët parashkollorë me depresion shfaqnin simptoma "tipike" dhe shenja vegetative të depresionit më shpesh se simptomat e tjera jo të efektshme ose "të maskuara". Anhedonia dukej të ishte një simptomë specifike dhe trishtimi/irritueshmëria dukej të ishte një simptomë e ndjeshme e depresionit parashkollor. Simptomat "e maskuara" të depresionit ndodhin tek fëmijët parashkollorë por nuk mbi vepron tabloja klinike. Studimet e ardhshme të projektuara posaçërisht për të hetuar specifikën dhe ndjeshmërinë e simptomave të depresionit parashkollor tani janë të garantuara (Luby, etj., 2003).

Në librin e tij Goleman (Goleman, 2018), paraqet përvojën e tij të intervistimit të psikologes Maria Kovasc, e cila punon në Universitetin e Psikiatrisë dhe Klinikën Uestern të Pitsburg-ut, e cila studioi fëmijët e diagnostikuar me depresion nga mosha tetë vjeçare dhe i kontrollonte herë pas here deri në moshën 24 vjeçare. Sipas saj, fëmijët që kalojnë depresion të lehtë kanë më tepër gjasa që ai t'u përkeqësohet në depresion të rënduar, i ashtuquajtur depresion i dyfishtë. Fëmijët që vuajnë nga depresioni janë zakonisht fëmijët më të shpërfillur dhe të vetmuar të shkollës. Trishtimi dhe mërzia që këta fëmijë ndiejnë, i shtyn t'i shmangin kontaktet shoqërore dhe të ngurrojnë t'u përgjigjen fëmijëve të tjerë, më pas ky ngurrim bëhet shkak që fëmijët e prekur me depresion të përfundojnë të vetmuar dhe të papërfshirë në lojërat e të tjerëve. Goleman, gjithashtu thekson që këta fëmijë janë më të ngurtë në marrëdhëniet shoqërore, kanë më pak shokë, gëzojnë më pak popullaritet, kanë marrëdhënie më të vështira se fëmijët tjerë e gjithashtu vërehet përparim i dobët në mësim. Një studim tjetër jep prova se çrregullimi i madh depresiv ekziston tek fëmijët parashkollorë dhe se ngjarjet stresuese të jetës shoqërohen me simptoma depresive, në të njëjtën kohë thekson rëndësinë e raportit të mësuesit për identifikimin e pranisë së depresionit në këtë grup-moshë (Kashani, Holcomb, & Orvaschel, 1986). Gjithashtu ekziston prova e drejtpërdrejtë, një studim pesëvjeçar mbi disa fëmijë të klasës së tretë, se një këndvështrim pesimist i rrezikon fëmijët në masë të madhe nga depresioni. Te fëmijët e vegjël, prirja pesimiste lidhej me një ngjarje tronditëse si divorci i prindërve apo një vdekje në familje.

Te këta fëmijë me qasje pesimiste, shpjegimi i humbjeve dhe dështimeve në jetë përmes të metave vetjake, i rrezikonte nga depresioni pas çdo disfate (Goleman, 2018).

Kujdesi dhe mbështetja familjare por edhe e shoqërisë është shumë e rëndësishme, sidomos në këto hapa të jetës së fëmijës, duhet marrë parasysh që ndonëse depresioni kalon, fëmija mbetet me plagë emocionale.

Turpi

Kritikat negative për vetveten sjellin në pah një ndjenjë që sjell parehati te individ, duke shkaktuar kështu emocionin që quhet turp. Ndjenjat e tilla si dobësia dhe ndjenja e poshtëruar ndaj individëve, të bën të ndihesh i gjykuar negativisht para shikuesve imagjinarë. Personat që posedojnë emocionin e turpit përqendrohen vazhdimisht në atë se çfarë mendojnë të tjerët për gabimet e tyre (Tangney, 1995). Turpi lidhet me moralin, me fajin e kryer, me të ndjerit keq, me dënimin. Fëmija që ka turp ndihet përgjegjës për një gabim, i cili e ka veçuar atë nga shoqëria, motrat etj. I turpshëm është fëmija i pasigurt se pas aktit të kryer do të pranohet apo gjejë falje. Sipas psikologëve Mosher dhe White nga Universiteti i Connecticut, në jetë, ndërsa hasemi me situata që mbartin turp në krahasim me ndrojtjen, të ndjerin turp e kanë cilësuar si një eksperiencë shumë të parehatshme që lidhet ngushtë me zemërimin, fajin, stresin (Mosher & White, 1981).

Themelet e ndjenjave të turpit dhe të fajit hidhen që në fëmijëri. Turpi dhe ndjenjat e fajit, mund të konsiderohen si emocione udhërrëfyese me një efekt nxitës në situata të kualifikueshme kur fëmijët rrezikojnë të përjashtohen nga grupi (Gilbert, 2003). Përveç karakteristikave personale të fëmijëve edhe qëndrimet e familjes janë të rëndësishme në formimin e turpit dhe fajit te fëmijët. Duke u bazuar në të dhënat e hulumtimit Erdoğan, thekson se ndjenja e turpit nuk ndryshon sipas ndryshores së nivelit të klasës përderisa faji u gjet të ulej me rritjen e nivelit të klasës. Gjithashtu u arrit në përfundimin se vajzat kishin nivele më të larta turpi dhe faji se djemtë (Erdoğan, 2019).

Ndrojtja

Ndrojtja është fobi sociale, paaftësi për t'u socializuar, influencohet nga stilet e prindërimit dhe mjedisi rrethues. I ndrojturi është individi që ndodhet midis frikës dhe të qenit i padukshëm ndjehet i veçuar apo i dukshëm, por pa vlerë. Druajtja është një tipar temperamenti i karakterizuar nga gatishmëria, frika dhe vetëdija në situatat shoqërore. Në shkollën fillore, ndrojtja e fëmijëve shoqërohet me një gamë të gjerë vështirësish socio-emocionale, duke përfshirë marrëdhënie të dobëta me bashkëmoshatarët (p.sh., përjashtimi, viktimizimi), problemet e brendshme (p.sh., vetëvlerësimi i ulët, ankthi, depresioni) dhe problemet e përshtatjes akademike (p.sh. mungesa e angazhimit, performanca e dobët akademike).

Ndrojtja mund të shfaqet si frenim, frikë dhe shmangie në kontekstin e risive shoqërore dhe situatave të vlerësimit shoqëror të perceptuar. Në një studim, druajtja e vëzhguar e fëmijëve u karakterizua më së miri nga dy trajektore, duke përfshirë një klasë me qëndrueshmëri të lartë (19%) dhe një klasë të ulët të qëndrueshme (81%). Vajzat kishin më shumë gjasa se djemtë të ndiqnin një model të ndrojtjes së vërejtur me qëndrueshmëri të lartë. Për më tepër, fëmijët në klasën e ndrojtjes të vëzhguar me qëndrueshmëri të lartë u vlerësuan nga prindërit dhe mësuesit si më të shqetësuar nga shoqëria në krahasim me fëmijët në klasën e ulët të qëndrueshme, dhe djemtë në klasën e ndrojtjes të vëzhguar me qëndrueshmëri të lartë u vlerësuan nga mësuesit e tyre si më depresivë simptoma në lidhje me vajzat. Këto gjetje sugjerojnë që një nëngrup i fëmijëve shfaqin ndrojtje të qëndrueshme të sjelljes, dhe kjo lidhet me funksionimin psikosocial (Poole, Cunningham, & Schmidt, 2020).

Performanca akademike

Fuqia njerëzore është burimi më i çmuar i një vendi. Shkollat janë vendi i shndërrimit të këtyre burimeve të vlefshme në fuqi. Sot, veçanërisht janë të nevojshëm individ që kanë arritur aftësi të të menduarit shkencor, produktiv, kreativ, krijues dhe kanë fituar shkathtësi në zgjidhjen e problemeve të ndryshme. Për të rritur nivelet e arritjeve të studentëve dhe për të siguruar që ata të rriten si individë të kualifikuar është e nevojshme të kryhen një seri transformimesh në sistemet arsimore. Suksesi përkufizohet si arritja e qëllimit të caktuar dhe e asaj që është e

dëshiruar. Shikuar në aspektin arsimor, sukcesi është një grup sjelljesh në përputhje me objektivat e programit

Performanca akademike është shkalla në të cilën një student, mësues ose institucion ka arritur qëllimet e tyre të arsimit të shkurtër ose afatgjatë. GPA kumulative dhe plotësimi i standardeve arsimore siç janë diplomat e shkollave të mesme dhe gradat Bachelor paraqesin arritje akademike. Arritja akademike zakonisht matet përmes provimeve ose vlerësimeve të vazhdueshme, por nuk ekziston një marrëveshje e përgjithshme mbi atë se si vlerësohet më së miri ose cilat aspekte janë më të rëndësishme - njohuri procedurale siç janë aftësitë ose njohuritë deklarative siç janë faktet (Ward, Stoker, & Murray-Ward, 1996).

Origjina e matjes së performancës akademike në Shtetet e Bashkuara daton në vitet 1830. Mbrojtësit e arsimit Horace Mann dhe Samuel Gridley Howe përdorën një test të standardizuar për të vlerësuar përparimin e studentëve në Boston. Administratori i shkollës në Kansas Frederick J. Kelly përparoi idenë e testimit të standardizuar me Testin e Leximit të Heshtur të Kansasit në vitin 1914. Ky test me zgjedhje të shumëfishta u përdor për të reduktuar kohën e gradimit dhe vlerësimet e standardizuara të studentëve. Punonjësi i IBM Reynold B. Johnson zhvilloi një makinë gradimi në vitin 1934 që mund të diplomojë fletët e provës duke marrë rrymën elektrike të krijuar nga shenjat e lapsave. Henry Chauncey zhvilloi Testin e Vlerësimit Scholastic (SAT) në vitin 1934 për të vlerësuar kandidatët për bursë në Universitetin e Harvardit dhe Profesori i Universitetit të Iowa-s E.F. Lindquist krijoi versionin e parë të American College Test (ACT) në vitin 1959 (ProCon.org, 2020).

Faktorët që ndikojnë në performancën akademike

Çdo fëmijë është unik dhe ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në performancën akademike të një fëmije. Faktorët kryesorë që përcaktojnë arritjet akademike të fëmijëve janë:

1. *Niveli i maturimit të fëmijës* - Disa fëmijë janë më të përgatitur se të tjerët për të filluar karrierën e tyre akademike. Kjo ka të bëjë me zhvillimin unik të çdo individit. Me kalimin e kohës, fëmija do të mësohet me mjedisin e ri dhe do të përshtatet me ritmin e ri.
2. *Personaliteti dhe gjendja emocionale* - Fëmijët që kanë më shumë stabilitet emocional demonstrojnë një aftësi më të madhe për t'u përballur me kërkesat e shkollës dhe për t'iu përshtatur më mirë mjedisit. Ata sillen në një mënyrë të lehtë, të respektuar dhe miqësore. Fëmijët që tregojnë shenja ankthi, agresioni ose depresioni kanë më shumë vështirësi në marrjen e rezultateve të mira.
3. *Prindërit* - Fëmijët janë një pasqyrim i shembullit që prindërit u kanë dhënë gjithë jetën e tyre. Nëse fëmijët vëzhgojnë qëndrime dhe sjellje të përgjegjshme dhe të vazhdueshme, ata me siguri do t'i imitojnë ato. Përgatitja që zhvillohet para një faze të re në shkollë është gjithashtu një mjet i fuqishëm që prindërit mund t'u japin fëmijëve të tyre. Megjithatë, autoritarizmi nuk ndihmon.
4. *Mësimdhënësit* - Një marrëdhënie pozitive dhe e respektuar mes mësuesve dhe fëmijëve është çelësi i suksesit akademik të një fëmije. Pra, natyrisht, aftësia e mësuesit për të dhënë njohuri. Si prind, duhet të shmangni të bëni komente negative para fëmijës tuaj lidhur me mësuesin e tij ose të saj. Kjo mund të rezultojë në një mungesë respekti në emër të fëmijës tuaj ndaj edukatorit. Në të njëjtën kohë, fëmija juaj mund të përfundojë duke u ndier i hutuar në lidhje me dy nga figurat më të rëndësishme të autoritetit: nëna dhe mësuesi (You are Mom, 2018).

Në gjetjet e tyre Lee dhe Shutte dokumentuan gjetjet empirike që kanë treguar marrëdhënie të veçanta midis faktorëve të shqyrtuar personalë dhe social-kontekstualë dhe arritjeve akademike, kryesisht në fushat e leximit dhe matematikës (Lee & Shute, 2010). Gjithashtu nga studimi ku u eksploruan variablat psikosociale si shërbimi i komunitetit, motivimi akademik, mbështetja sociale dhe metodat e studentëve për trajtimin e padrejtë, rezultatet treguan se metoda e trajtimit të padrejtë ishte e lidhur pozitivisht me arritjen akademike (Powell & Arriola, 2003).

Studime lidhur me ndikimin e vështirësive emocionale në performancën akademike

Studimet kanë treguar se të rinjtë me probleme të shëndetit mendor kanë arritje më të ulëta akademike, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre (McLeod, Uemura, & Rohrman, 2012). Ka evidenca të fuqishme se vështirësitë emocionale janë të lidhura me vështirësitë akademike (Arnold, 1997) dhe (Hinshaw, 1992).

Hulumtimet kanë demonstruar se aftësitë për rregullimin e emocioneve janë të lidhura ngushtë me arritjet akademike (Wentzel & Asher, 1995). Vitet e fundit është duke u shtuar evidenca se nxënësit me probleme emocionale marrin nota më të ulëta në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre që nuk shfaqin këto problematika (Wagner & Cameto, 2004). Gjithashtu shkathtësitë sociale dhe rregullimi emocional kanë efekt mbi cilësinë e raporteve sociale në shkollë dhe duket se kjo variabël ndikon mbi motivimin dhe performancën shkollore (Furrer & Skinner, 2003).

Studimet vënë në dukje se ankthi e pengon procesin e të nxënësve dhe ecurinë në test. Kur nxënësit janë duke mësuar një material të ri, ata duhet t'i kushtojnë vëmendje. Nxënësit që janë shumë në ankth, në vend që të përqendrohen, ata vazhdojnë ta kenë mendjen të ngushtimi që ndiejnë në kraharor. Përgjithësisht këta nxënës nga ndjenja që u pushton trupin e tyre mund të humbasin që në fillim informacionin, ngaqë mendimet u janë mbërthyer te shqetësimet që ndiejnë (Cassady & Johnson, 2002). Por edhe sikur ta përqendrojnë vëmendjen, shumë nxënës të pushtuar nga ankthi kanë vështirësi në mësimin e materialit që mund të jetë disi i vështirë, material që kërkon të mbështeten te kujtesa e tyre. Të nxënësve e shprehive për të qenë më të qetë nuk e përmirëson automatikisht ecurinë mësimore të këtyre nxënësve, pasi ata duhet të përmirësojnë edhe strategjitë e tyre mësimore, edhe aftësitë e tyre të të nxënësve (Naveh-Benjamin, 1991).

Rezultatet treguan se nxënësit që ndihen në ankth shpesh dinë më shumë nga sa shfaqin në teste si dhe treguan një disavantazh në organizimin e materialit, në krahasim me të tjerët. Atyre mund tu mungonin aftësitë e përpunimit të informacionit ose mund ta kenë mësuar

materialin, pasi kanë aftësi në përpunimin e informacionit, por gjatë testimit i harrojnë ato (Naveh-Benjamin; McKeachie & Lin, 1987). Ankthi mund të jetë edhe shkak, edhe pasojë e dështimit në shkollë – nxënësit kanë ecuri të dobët në mësim, sepse ndjejnë ankth dhe nga ana tjetër, performanca e tyre e dobët e shton ankthin. Ankthi ndoshta është tipar, edhe gjendje. Disa nxënës priren të jenë në ankth në shumë situata (ankthi si tipar), por disa situata janë nxitëse të ankthit (ankthi si gjendje) (Zeidner, 1998).

Sipas (Goleman, 2018), studimet dhe intervistat e tij me Kovasc, vënë në dukje se edhe depresioni ndikon në përparimin e fëmijëve në mësim. Depresioni ua dëmton kujtesën dhe përqendrimin duke ua vështirësuar së tepërmi përhithjen dhe ngulitjen e informacionit. Nëse një fëmijë nuk i gëzohet asgjëje, nuk do të ketë edhe energji as kënaqësinë e të mësuarit. Gjithashtu u vërejt që sa më shumë zgjaste depresioni i fëmijëve, aq më të dobëta ishin rezultatet e tyre në shkollë. Pra, sipas tyre u vë një korrelacion i drejtpërdrejtë mes kohëzgjatjes së depresionit të një fëmije dhe rënies së notës mesatare. E, sigurisht që problemet akademike në të njëjtën kohë shtonin edhe depresionin. Sipas Karadağ, në studimin e kryer, vërehet një nivel i lartë i nivelit të depresionit dhe ankthit, në adoleshentët që braktisën shkollën (Karadağ, 2020).

III. METODOLOGJIA

Hulumtimi ynë ka vijuar me metodologjinë kuantitative ku me ndihmën e pyetësorit janë mbledhur të dhëna sasiore parësore lidhur me studimin në fjalë. Studimi ka karakter eksplorues ku është përdorur qasja pozitiviste (pra, nisemi nga premisa që bota shoqërore është e vërtetë dhe mund të studiohet), e cila lejon të mbledhim të dhëna sasiore, duke mundësuar matjen e aspekteve dhe dukurive shoqërore si dhe analizimin e të dhënave të mbledhura në mënyrë statistikore.

Target grupi i këtij hulumtimi përbëhet nga mësimdhënësit e shkollave fillore të Komunës së Prizrenit. Gjatë hulumtimit është përdorur kampioni i rastësishëm, ndërsa për ta përmirësuar përfaqësueshmërinë e kampionit është bërë shtresëzimi i tij, duke marrë parasysh karakteristikat të caktuara të njohura si gjinia, mosha, grupi socio-ekonomik që janë domethënëse për studimin.

Mostra e hulumtimit

Hulumtimi është realizuar në këto shkolla të Komunës së Prizrenit, të cilat paraqesin mostrën e hulumtimit: “Emin Duraku”, “Mustafa Baku”, “Fadil Hisari”, “Hasim Maliqaj”, “Besim Ndrecaj”, “Abdyl Frashëri”, “Lidhja e Prizrenit”, “Naim Frashëri”, “Lekë Dukagjini”, “Mati Logoreci”, “Dëshmorët e Vërrinit” si dhe “Ekrem-Rexha Drini”.

Mostrën e këtij hulumtimi e përbëjnë 113 mësimdhënës të cilët janë punonjës të SH.F.M.U të zonave urbane dhe atyre rurale. Mësimdhënësit janë zgjedhur në mënyrë rastësore, ashtu që të kemi një përfaqësim të denjë të tyre në hulumtim. Secili mësimdhënës e plotësoj pyetësorin duke u bazuar në nxënësin që mendonte që i ka këto vështirësi. Aspektet e tjera demografike si gjinia, mosha, kualifikimi dhe përvoja e punës ishin sipas mostrës së rastësishme. Më poshtë është paraqitur edhe tabela me karakteristikat përshkruese të mostrës.

Tabela 1. Karakteristikat përshkruese të mostrës

Shkolla	N	%
“Mustafa Baku”	8	7.1
“Fadil Hisari”	24	21.2
“Abdyl Frashëri”	13	11.5
“Emin Duraku”	14	12.4
“Mati Logoreci”	11	9.7
“Lekë Dukagjini”	7	6.2
“Lidhja e Prizrenit”	7	6.2
“Naim Frashëri” – Vlashnjë	6	5.3
“Hasim Maliqaj” – Poslisht	11	9.7
“Ekrem Rexha Drini” – Lubizhdë	5	4.4
“Dëshmorët e Vërrinit” – Billushë	3	2.7
“Besim Ndrecaj” – Llutogllavë	4	3.5

Instrumentet e hulumtimit

Për qëllim të mbledhjes së të dhënave është përdorur Pyetësi i Vështirësive dhe Fuqive - SDQ questionnaire (Goodman, 1997). Ky pyetësor i përmban 25 pyetje të klasifikuara në 5 nënshkallë të cilat matin emocionalitetin, hiperaktivitetin, problemet me moshatarët dhe sjelljet sociale. Në fillim të pyetësit janë të vendosura pyetjet, me anë të cilave synohet të merret informacion i përgjithshëm për respondentët e këtij hulumtimi. Gjithashtu nga katër nënshkallët e para mund të llogaritet edhe një variabël gjithëpërfshirëse e cila vlerëson

vështirësitë në total. Pyetësi është i formës Likert me tri mundësi të përgjigjes: *jo e vërtetë, disi e vërtetë dhe tërësisht e vërtetë*. Ky pyetësor është përdorur në shumë studime nëpër botë (Goodman, Ford, Simmons, Gatward, & Meltzer, 2000). Në Kosovë gjithashtu është përdorur në aspektin e instrumentit ndihmës në vlerësimin e fëmijëve (Fanaj, Melanoshi, & Shkëmbi, 2015), dhe në një studim për krahasimin midis rasteve klinike dhe kampionit të komunitetit të adoleshentëve (Fanaj, Poniku, Gashi, Vehbiu, & Morina, 2012). Pyetësi kërkon 10-15 minuta për t'u plotësuar.

Procedura e hulumtimit

“Çfarëdo që të jetë suksesi që ka arritur ndokush, fillimi i atij suksesi është në vendin dhe momentin kur ai e ka menduar atë të arriturën, çfarëdo të ketë qenë ai vend.”

Dr. Ibrahim el-

Fekij

Gjithçka filloi me idenë dhe dëshirën për të hulumtuar ndikimin që kanë vështirësitë emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të moshës shkollore. Në fazën e parë vendosa se çfarë do të jetë në fokusin e hulumtimit tim, ashtu që nga problemi i përgjithshëm madhor, të nxjerr pyetjen kryesore hulumtuese. Hapi tjetër që kam bërë është kërkesa për pëlqimin e DKA-së, për kryerjen e hulumtimit në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Prizrenit. E më pas, pasi mora pëlqimin vazhdova me procesin e anketimit në shkollat, duke filluar në shkollat e afërta e më pas edhe në ato rurale të qytetit të Komunës së Prizrenit. Puna në teren, procesi i grumbullimit të të dhënave ka zgjatur një muaj dhe është monitoruar dhe udhëhequr personalisht nga unë. Gjatë kryerjes së anketimit jam munduar t'i zbatojë parimet etike të hulumtimit, duke iu sqaruar mënyrën e plotësimit të pyetësorit, qëllimin e hulumtimit, duke iu ruajtur atyre konfidencialitetin. Mësimdhënësit morrën pjesë në anketim me vullnet të plotë dhe dëshirë. Pas mbledhjes së të dhënave bëra analizën e dhënave të grumbulluara dhe paraqitjen statistikore të tyre përmes programit SPSS. Duke u bazuar në rezultatet e fituara nxorra konkludime dhe rekomandime kundrejt organeve kompetente.

IV. ANALIZA E TË DHËNAVE DHE REZULTATET

Kapitulli i katërt i këtij hulumtimi përbëhet nga analiza e të dhënave dhe rezultatet. Ky kapitull do të fillojë me shqyrtimin e profilit demografik të respondentëve duke vazhduar me përgjigjet e tyre lidhur me ndikimin e vështirësive emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor në Komunën e Prizrenit.

Të dhënat kuantitative janë analizuar përmes metodave statistikore duke aplikuar një prej programeve statistikore, në rastin tim programin SPSSv.25. Fillimisht janë aplikuar analizat deskriptive të cilat janë paraqitur përmes numrit të rasteve dhe përqindjes, kurse analiza e korrelacionit, H_i^2 dhe Independent sample t-test janë aplikuar për të vërtetuar hipotezat e hulumtimit. Niveli i marginës së gabimit e cila është përdorur për të vërtetuar hipotezat është 0.01 dhe 0.05. Përmes analizës së korrelacionit kam analizuar lidhjen në mes të vështirësive emocionale dhe arritjeve akademike, pastaj përmes analizës me testin H_i^2 (Chi square) kam analizuar dallimet në mes mësimdhënësve të gjinisë mashkullore dhe femërore në raport me nivelin e njohurive të mësimdhënësve me problemet e vështirësive emocionale dhe arritjeve akademike të nxënësve, kurse përmes Independent sample t-test kam krahasuar dallimin në mes nxënësve meshkuj dhe femra dhe vështirësive emocionale.

Profili demografik i respondentëve do të pasqyrohet përmes pyetjeve të nxjerra nga pjesa fillestare e pyetësorit (Pjesa A), e cila përmban pyetje për institucionin, lokacionin e institucionit, gjininë e mësimdhënësve dhe të fëmijëve, moshën e mësimdhënësve dhe të fëmijëve, nivelin e shkollimit si dhe përvojën e përgjithshme të viteve të punës në arsim.

Siç shihet nga tabela 2, këtij pyetësori i janë përgjigjur 113 respondentë, nga të cilët nga institucioni SHFMU “Mustafa Bakiu” janë 7.1 % e respondentëve, nga SHFMU “Fadil Hisari” janë 21.2% e respondentëve, nga SHFMU “Abdyl Frashëri” janë 11.5% e respondentëve, nga SHFMU “Emin Duraku” janë 12.4% e respondentëve, nga SHFMU “Mati Logoreci” janë 9.7% e respondentëve, nga SHFMU “Lekë Dukagjini” janë 6.2% e respondentëve, nga SHFMU “Lidhja e Prizrenit” janë 6.2% e respondentëve, nga SHFMU “Naim Frashëri” janë 5.3% e respondentëve, nga SHFMU “Hasim Maliqaj” janë 9.7% e respondentëve, nga SHFMU “Ekrem Rexha Drini”

janë 4.4% e respondentëve, nga SHFMU “Dëshmorët e Vërrinit” janë 2.3% e respondentëve dhe nga SHFMU “Besim Ndrecaj” janë 3.5% e respondentëve.

Tabela 2. Respondentët sipas institucionit

Shkolla	N	%
“Mustafa Bakiu”	8	7.1
“Fadil Hisari”	24	21.2
“Abdyl Frashëri”	13	11.5
“Emin Duraku”	14	12.4
“Mati Logoreci”	11	9.7
“Lekë Dukagjini”	7	6.2
“Lidhja e Prizrenit”	7	6.2
“Naim Frashëri” – Vlashnjë	6	5.3
“Hasim Maliqaj” – Poslisht	11	9.7
“Ekrem Rexha Drini” – Lubizhdë	5	4.4
“Dëshmorët e Vërrinit” – Billushë	3	2.7
“Besim Ndrecaj” – Llutogllavë	4	3.5

Në tabelën 3, janë paraqitur respondentët sipas lokacioneve në të cilat gjenden institucionet edukativo-arsimore ku ata punojnë. Në këtë hulumtim, 27.5% e respondentëve janë nga lokacioni rural, kurse 72.5% e respondentëve nga lokacioni urban. Shkollat janë zgjedhur në mënyrë të qëllimshme, 5 shkolla të rajonit rural dhe 7 shkolla të rajonit urban.

Tabela 3. Responentët sipas lokacionit

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Fshat	29	27,5	27,5	27,5
	Qytet	84	72,5	72,5	100,0
	Total	113	100,0	100,0	

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur moshja e fëmijëve, për të cilët mësimdhënësit plotësuan të dhënat në pyetësor. Sipas tyre, 8.8% e fëmijëve ishin të moshës 6 vjeç; 18.6% e fëmijëve ishin të moshës 7 vjeç; 16.8% e fëmijëve ishin të moshës 8 vjeç; 22.1% e fëmijëve ishin të moshës 9 vjeç; 21.2% e fëmijëve ishin të moshës 10 vjeç dhe 12.4% e fëmijëve ishin të moshës 11 vjeç. Siç shihet nga tabela, fëmijët të moshës 9 dhe 10 vjeç mbizotërojnë me përqindje më të lartë, përderisa përqindja më e vogël i takon moshës 6 vjeç. Sipas këtyre rezultateve konstatojmë se fëmijët e moshës 6 vjeçare janë më pak të prekur nga vështirësitë emocionale, kurse më të prekur nga këto vështirësi shihet moshja 9 dhe 10 vjeçare e fëmijëve.

Tabela 4. Moshja e fëmijëve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	6 vjeç	10	8,8	8,8	8,8
	7 vjeç	21	18,6	18,6	27,4
	8 vjeç	19	16,8	16,8	44,2
	9 vjeç	25	22,1	22,1	66,3
	10 vjeç	24	21,2	21,2	87,5
	11 vjeç	14	12,4	12,4	100,0
	Total	113	100,0	100,0	

Në tabelën 5, është paraqitur gjinia e fëmijëve që ishin pjesë e hulumtimit. Sipas rezultateve shihet që 60.8% e fëmijëve ishin të gjinisë femërore dhe 39.2% e fëmijëve ishin të gjinisë mashkullore.

Tabela 5. Gjinia e fëmijës

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	68	60,8	60,8	60,8
	Mashkull	45	39,2	39,2	100,0
	Total	113	100,0	100,0	

Në pyetësin e këtij hulumtimi kanë marrë pjesë gjithsej njëqind e trembëdhjetë respondentë, prej tyre 24.8% të grup moshës 23-35 vjeç; 28.3% të grup moshës 36-45 vjeç; 38.1% të grup moshës 46-55 vjeç dhe 8.8% të grup moshës mbi 56 vjeç.

Tabela 6. Mosha e mësimdhënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	23-35	28	24,8	24,8	24,8
	36-45	32	28,3	28,3	53,1
	46-55	43	38,1	38,1	91,2
	Mbi 56	10	8,8	8,8	100,0
	Total	113	100,0	100,0	

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet në lidhje me gjininë e respondentëve. Nga këto të dhëna kemi 85% të respondentëve femra dhe 15% të respondentëve meshkuj. Këto rezultate paraqesin një realitet të gjendjes së strukturës gjinore të Republikës së Kosovës dhe kjo ndodh për shkak se profesioni i mësimdhënësit në vendin tonë më së shumti synohet nga gjinia femërore.

Tabela 7. Gjinia e mësimdhënësve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Femër	96	85,0	85,0	85,0
	Mashkull	17	15,0	15,0	100,0
	Total	113	100,0	100,0	

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet në lidhje me nivelin e shkollimit të responentëve. Rezultatet tregojnë se kemi 9.7% të responentëve me përgatitjen profesionale të Shkollës së lartë; 69.9% prej tyre me përgatitjen profesionale Bachelor; 16.8% prej tyre me përgatitjen profesionale Master dhe 3.5% prej tyre me përgatitjen profesionale Doktoratë. Nga këto rezultate mund të theksojmë se është i kënaqshëm përfaqësimi i mësimdhënësve me përgatitjen profesionale Master e po ashtu edhe Doktoratë, por duhet të synojmë që kjo përqindje të rritet akoma më tepër.

Tabela 8. Paraqitja e nivelit të shkollimit të responentëve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Vali d	Shkolla e lartë	11	9,7	9,7	9,7
	Bachelor	79	69,9	69,9	79,6
	Master	19	16,8	16,8	96,4
	Doktoratë	4	3,5	3,5	100,0
	Total	113	100,0	100,0	

Në tabelën 9, janë paraqitur të dhënat e përvojës së përgjithshme të mësimdhënësve në arsim. Sa i përket gjatësisë së kohës së punës në institucione, nga responentët, kemi këto rezultate: 12.4% prej tyre punojnë më pak se një vit; 23.9% prej tyre në periudhën 1-10 vite; 32.7% prej tyre në periudhën 11-20 vite dhe 31% prej tyre punojnë më shumë se 20 vite. Sipas rezultateve, 31% e responentëve kanë përvojë pune mbi 20 vite, e kjo është shpresëdhënëse për hulumtimin pasi do të marrim një vlerësim real të gjendjes në institucione edukativo-arsimore.

Tabela 9. Responentët sipas përvojës në arsim

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Vali d	Më pak se një vit	14	12,4	12,4	12,4
	1-10 vite	27	23,9	23,9	36,3
	11-20 vite	37	32,7	32,7	69,0
	Më shumë se 20 vite	35	31,0	31,0	100,0
	Total	113	100,0	100,0	

Nga tabela 10 ku janë rezultatet e deklaratës “I merr në konsideratë ndjenjat e të tjerëve”, kuptojmë se 28 prej respondentëve pohojnë se kjo nuk është e vërtetë apo 24.8%, 47 prej tyre deklarojnë se është disi e vërtetë apo 41.6% ndërsa 36 respondentë apo 31.9% mendojnë se fëmijët i marrin në konsideratë ndjenjat e të tjerëve, duke thënë se tërësisht e vërtetë.

Tabela 10. I merr në konsideratë ndjenjat e të tjerëve

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	28	24.8	24.8	24.8
	Disi e vërtetë	47	41.6	41.6	66.4
	Tërësisht e vërtetë	36	31.9	31.9	98.2
	Total	113	100.0	100.0	

Të pyetur për deklaratën “Nervoz, tepër aktiv s’ mund të qëndrojnë në një vend për kohë të gjatë”, nga përgjigjet e respondentëve (shih tabelën 11), kuptojmë se fëmijët janë tepër aktiv e nuk mund të qëndrojnë në një vend për një kohë, pasi 34 thonë se është disi e vërtetë apo 30.1%, dhe 35 respondentë pohojnë se është tërësisht e vërtetë apo 31%. Kurse 43 respondentë deklarojnë se është jo e vërtetë apo 38.1%.

Tabela 11. Nervoz, tepër aktiv s’ mund të qëndrojnë në një vend për kohë të gjatë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	43	38.1	38.1	38.1
	Disi e vërtetë	34	30.1	30.1	68.1
	Tërësisht e vërtetë	35	31.0	31.0	99.1
	Total	113	100.0	100.0	

Sa i përket deklaratës “Shpesh ankohet për kokëdhimbje, dhimbje barku ose për sëmundje”, 38.9% e respondentëve apo 44 deklarojnë se kjo nuk është e vërtetë; 42.5% e respondentëve apo 48 deklarohen me përgjigjen disi e vërtetë; 18.6% e respondentëve apo 21 prej tyre deklaruan se është tërësisht e vërtetë apo 18.6%. Siç shihet nga përqindja më e lartë 42.5% e

respondentëve, fëmijët ankohen shpesh për kokëdhimbje, dhimbje barku ose për sëmundje, e cila lidhet drejtpërdrejtë me vështirësitë emocionale.

Tabela 12. Shpesh ankohet për kokëdhimbje, dhimbje barku ose për sëmundje

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	44	38.9	38.9	38.9
	Disi e vërtetë	48	42.5	42.5	81.4
	Tërësisht e vërtetë	21	18.6	18.6	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Siç shihet nga tabela e rezultateve e deklaratës “Me lehtësi i ndan me fëmijë të tjerë, p.sh. lojërat, ushqimin” kuptojmë se 18.6% e respondentëve apo 21 mësimdhënës deklaruan se nuk është e vërtetë; 44.2% e respondentëve apo 50 deklaruan se është disi e vërtetë dhe 37.2% e respondentëve apo 42 mendojnë se është tërësisht e vërtetë.

Tabela 13. Me lehtësi i ndan me fëmijë të tjerë, p.sh. lojërat, ushqimin

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	21	18.6	18.6	18.6
	Disi e vërtetë	50	44.2	44.2	62.8
	Tërësisht e vërtetë	42	37.2	37.2	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga tabela e rezultateve të deklaratës “Shpesh e humbet temperamentin (disponimin)” kuptojmë se 30.1% e respondentëve apo 34 deklaruan se nuk është e vërtetë; 34.5% e respondentëve apo 39 pohuan se është disi e vërtetë dhe 35.4% e respondentëve apo 40 pohuan se është tërësisht e vërtetë.

Tabela 14. Shpesh e humbet temperamentin (disponimin)

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	34	30.1	30.1	30.1
	Disi e vërtetë	39	34.5	34.5	64.6
	Tërësisht e vërtetë	40	35.4	35.4	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Në deklaratën “Preferon më tepër të rri vet se me fëmijët tjerë”, 40.7%, e respondentëve apo 46 nuk mendojnë se fëmijët preferojnë më tepër të rrin vet se me fëmijët tjerë; 31.9% e respondentëve deklarojnë se kjo është disi e vërtetë dhe 27.4% e respondentëve apo 31 mendojnë se fëmijët preferojnë të rrin më tepër vet se me fëmijët tjerë duke u përgjigjur tërësisht e vërtetë.

Tabela 15. Preferon më tepër të rri vet se me fëmijët tjerë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	46	40.7	40.7	40.7
	Disi e vërtetë	36	31.9	31.9	72.6
	Tërësisht e vërtetë	31	27.4	27.4	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Në tabelën 16 janë prezantuar të dhënat e deklaratës “Në përgjithësi sillen mirë, zakonisht bën atë që ia kërkojnë të rriturit”, nga ku kuptojmë se 12.4% e respondentëve apo 14 pohojnë se është jo e vërtetë, 52.2% e respondentëve apo 59 pohojnë se është disi e vërtetë, ndërsa 35.4% e respondentëve apo 40 pohojnë se është tërësisht e vërtetë. Në këtë rast, nëse largohet përgjigjja negative “jo e vërtetë” vërejmë se 87.6% e respondentëve mendojnë se fëmijët në fjalë në përgjithësi sillen mirë e zakonisht bëjnë atë që u kërkojnë të rriturit.

Tabela 16. Në përgjithësi sillen mirë, zakonisht bën atë që ia kërkojnë të rriturit

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	14	12.4	12.4	12.4
	Disi e vërtetë	59	52.2	52.2	64.6
	Tërësisht e vërtetë	40	35.4	35.4	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Siç shihet nga tabela e rezultateve (tabela 17), e deklaratës “Shumë shqetësime ose shpesh duket i shqetësuar”, kuptojmë se 36.3% e respondentëve apo 41 deklarojnë se është jo e vërtetë; 38.9% apo 44 thonë se kjo është disi e vërtetë dhe 24.8% e respondentëve apo 28 deklarojnë se është tërësisht e vërtetë që fëmijët kanë shumë shqetësime ose shpesh duken të shqetësuar.

Tabela 17. Shumë shqetësime ose shpesh duket i shqetësuar

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	41	36.3	36.3	36.3
	Disi e vërtetë	44	38.9	38.9	75.2
	Tërësisht e vërtetë	28	24.8	24.8	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Të pyetur për deklaratën “Dobishëm (ndihmues) nëse dikush lëndohet, mërzhitet ose ndjehet i sëmurë”, 18.6% e respondentëve apo 21 pohojnë se është jo e vërtetë; 53.1% e respondentëve apo 60 deklarohen me disi e vërtetë dhe 28.3% e respondentëve apo 32 deklarohen se kjo është tërësisht e vërtetë. Në këtë rast, nëse largohet deklarimi jo e vërtetë, vërehet se 80.4% e respondentëve mendojnë fëmijët ndihmojnë nëse dikush lëndohet, mërzhitet ose ndjehet i sëmurë.

Tabela 18. Dobishëm (ndihmues) nëse dikush lëndohet, mërzhitet ose ndjehet i sëmurë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	21	18.6	18.6	18.6
	Disi e vërtetë	60	53.1	53.1	71.7
	Tërësisht e vërtetë	32	28.3	28.3	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga tabela e rezultateve e deklaratës “Vazhdimisht luhatet ose bën lëvizje nervozizmi”, kuptojmë se 36.3% e respondentëve apo 41 pohojnë se është jo e vërtetë; 38.9% e respondentëve apo 44 pohojnë se është disi e vërtetë dhe 24.8% e respondentëve apo 28 mendojnë se është tërësisht e vërtetë, pra fëmijët vazhdimisht luhaten ose bëjnë lëvizje nervozizmi.

Tabela 19. Vazhdimisht luhatet ose bën lëvizje nervozizmi

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	41	36.3	36.3	36.3
	Disi e vërtetë	44	38.9	38.9	75.2
	Tërësisht e vërtetë	28	24.8	24.8	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Siç shihet nga rezultatet e deklaratës “Ka së paku një shokë të mirë”, 23% e respondentëve apo 26 deklarohen se është jo e vërtetë; 46.9% e respondentëve apo 53 pohojnë se është disi e vërtetë dhe 30.1% e respondentëve apo 34 pohojnë se është tërësisht e vërtetë. Në këtë rast, nëse largojmë përgjigjen “jo e vërtetë”, 77% e respondentëve mendojnë se fëmijët kanë së paku një shokë të mirë.

Tabela 20. Ka së paku një shokë të mirë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	26	23.0	23.0	23.0
	Disi e vërtetë	53	46.9	46.9	69.9
	Tërësisht e vërtetë	34	30.1	30.1	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga përgjigjet e respondentëve në deklaratën “Shpesh grindet me fëmijët tjerë ose i ngacmon ata”, kuptojmë se 38.1% e respondentëve apo 43 pohojnë se është jo e vërtetë; 37.2% e respondentëve apo 42 e shohin si disi të vërtetë dhe 24.8% e respondentëve apo 28 deklarojnë se është tërësisht e vërtetë. Në këtë rast, vërejmë se ndonëse pjesa më e madhe 38.1% kanë deklaruar se fëmijët nuk grinden shpesh me fëmijët tjerë ose nuk i ngacmojnë ata, në anën tjetër me deklaratat disi e vërtetë dhe tërësisht e vërtetë 62% e respondentëve pohojnë se fëmijët grinden shpesh me fëmijët tjerë ose i ngacmojnë ata.

Tabela 21. Shpesh grindet me fëmijët tjerë ose i ngacmon ata

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	43	38.1	38.1	38.1
	Disi e vërtetë	42	37.2	37.2	75.2
	Tërësisht e vërtetë	28	24.8	24.8	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga tabela rezultateve e deklaratës “Shpesh është i trishtuar, i dëshpëruar ose i përlotur”, kuptojmë se 30.1% e respondentëve pohojnë se është jo e vërtetë; 37.2% e respondentëve apo 42 deklarojnë se është disi e vërtetë dhe 32.7% e respondentëve apo 37 tërësisht e vërtetë.

Tabela 22. Shpesh është i trishtuar, i dëshpëruar ose i përlotur

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	34	30.1	30.1	30.1
	Disi e vërtetë	42	37.2	37.2	67.3
	Tërësisht e vërtetë	37	32.7	32.7	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Rezultatet e deklaratës “Në përgjithësi, fëmijët tjerë e duan atë” na bëjnë të kuptojmë se 11.5% apo 13 e respondentëve pohojnë se është jo e vërtetë; 44.2% e respondentëve apo 50 deklarohen disi e vërtetë dhe 44.2% e respondentëve apo 50 thonë se është tërësisht e vërtetë. Në

këtë rast, nëse largojmë përgjigjen “jo e vërtetë, vërejmë qartë se 88.5% e respondentëve mendojnë se fëmijët tjerë e duan në përgjithësi fëmijën në fjalë.

Tabela 23. Në përgjithësi, fëmijët tjerë e duan atë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	13	11.5	11.5	11.5
	Disi e vërtetë	50	44.2	44.2	55.8
	Tërësisht e vërtetë	50	44.2	44.2	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Respondentët të pyetur për deklaratën “Hutohet me lehtësi, humbet përqendrimin” dhanë këto përgjigje: 22.1% e respondentëve apo 25 deklarohen se jo e vërtetë; 32.7% e respondentëve apo 37 thonë se është disi e vërtetë dhe 45.1% e respondentëve apo 51 mendojnë se është tërësisht të vërtetë. Pra, shihet qartë se pjesa më e madh e respondentëve, 45.1% mendojnë se fëmijët hutohen lehtë dhe e humbin përqendrimin gjatë orës mësimore.

Tabela 24. Hutohet me lehtësi, humbet përqendrimin

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	25	22.1	22.1	22.1
	Disi e vërtetë	37	32.7	32.7	54.9
	Tërësisht e vërtetë	51	45.1	45.1	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Siç shihet nga tabela 25 e deklaratës “Nervoz në situatë të re, lehtë humbet besimin”, kuptojmë se 30.1% e respondentëve apo 34 e shohin si jo të vërtetë; 40.7% e respondentëve apo 46 si disi të vërtetë dhe 29.2% e respondentëve apo 33 mendojnë se është tërësisht e vërtetë.

Tabela 25. Nervoz në situatë të re, lehtë humbet besimin

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	34	30.1	30.1	30.1
	Disi e vërtetë	46	40.7	40.7	70.8
	Tërësisht e vërtetë	33	29.2	29.2	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga tabela e rezultateve e deklaratës “I sjellshëm me fëmijët më të rinj”, kuptojmë se 15.9% e respondentëve apo 18 pohojnë se nuk është e vërtetë; 42.5% e respondentëve apo 48 mendojnë se është disi të vërtetë dhe 41.6% e respondentëve apo 47 mendojnë se është tërësisht e vërtetë. Në këtë rast, po të largohet 15.9% e respondentëve, vërejmë që 84.1% e respondentëve pohojnë se në një mënyrë apo tjetër fëmijët në fjalë janë të sjellshëm me fëmijët më të rinj.

Tabela 26. I sjellshëm me fëmijët më të rinj

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	18	15.9	15.9	15.9
	Disi e vërtetë	48	42.5	42.5	58.4
	Tërësisht e vërtetë	47	41.6	41.6	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Rezultatet e tabelës njëzet e shtatë, lidhur me deklaratën “Shpesh gënjen ose mashtron”, tregojnë se 46% e respondentëve apo 52 pohojnë se është jo e vërtetë; 26.5% e respondentëve apo 30 e shohin si disi të vërtetë dhe 27.4% e respondentëve apo 31 mendojnë se është tërësisht e vërtetë. Nga kjo deklaratë e parashtruar në pyetësin për mësimdhënës kuptojmë se pjesa më e madhe 46% e respondentëve mendojnë se fëmijët nuk gënjejnë ose mashtrojnë.

Tabela 27. Shpesh gënjen ose mashtron

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	52	46.0	46.0	46.0
	Disi e vërtetë	30	26.5	26.5	72.6
	Tërësisht e vërtetë	31	27.4	27.4	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Siç shihet nga të dhënat e tabelës 28, në deklaratën “Bie në sy ose ngacmohet nga fëmijët tjerë”, kuptojmë se 36.3% apo 41 e respondentëve se është jo e vërtetë; 48.7% e respondentëve apo 55 pohojnë se është disi e vërtetë dhe 15% e respondentëve apo 17 e shohin si tërësisht të vërtetë. Siç shihet nga kjo deklaratë e parashtruar në pyetësin për mësimdhënës, nëse largohet përqindja më e vogël 15% e respondentëve me deklaram tërësisht e vërtetë, pjesa tjetër 85% mendojnë se fëmijët në fjalë bien në sy ose ngacmohen nga fëmijët tjerë.

Tabela 28. Bie në sy ose ngacmohet nga fëmijët tjerë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	41	36.3	36.3	36.3
	Disi e vërtetë	55	48.7	48.7	85.0
	Tërësisht e vërtetë	17	15.0	15.0	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga tabela 29 e rezultateve e deklaratës “Shpesh u ofron ndihmë të tjerëve (prindërve, mësuesve, fëmijëve)”, kuptojmë se pohimin se 18.6% e respondentëve apo 21 e shohin si jo të vërtetë; 37.2% e respondentëve apo 42 e shohin si disi të vërtetë dhe 44.2% e respondentëve apo 50 pohojnë se është tërësisht e vërtetë. Në këtë rast, vërejmë që pjesa më e madhe e respondentëve 44.2% mendojnë që fëmijët shpesh u ofrojnë ndihmë të tjerëve, pra prindërve, mësuesve, fëmijëve.

Tabela 29. Shpesh u ofron ndihmë te tjerëve (prindërve, mësuesve, fëmijëve)

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	21	18.6	18.6	18.6
	Disi e vërtetë	42	37.2	37.2	55.8
	Tërësisht e vërtetë	50	44.2	44.2	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Të pyetur për deklaratën “I mendon gjërat para se të veprojnë”, respondentët dhanë këto përgjigje: 32.7% e respondentëve apo 37 e shohin si jo të vërtetë; 29.2% e respondentëve apo 33 si disi të vërtetë dhe 38.1% e respondentëve apo 43 mendojnë se është tërësisht e vërtetë.

Tabela 30. I mendon gjërat para se të veprojnë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	37	32.7	32.7	32.7
	Disi e vërtetë	33	29.2	29.2	61.9
	Tërësisht e vërtetë	43	38.1	38.1	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga të dhënat e prezantuara në tabelën 31 për deklaratën “Vjedh prej shtëpisë, shkollës ose gjetkë”, 69.9% e respondentëve apo 79 pohojnë se është jo e vërtetë; 14.2% e respondentëve apo 16 e shohin si disi të vërtetë dhe 15.9% e respondentëve pohojnë se kjo është tërësisht e vërtetë. Nga kjo deklaratë e parashtruar në pyetësorin për mësimdhënës, vërejmë që pjesa më e madhe 69.9% e mësimdhënësve mendojnë se fëmijët nuk vjedhin prej shtëpisë, shkollës ose gjetkë, e kjo është një gjë pozitive.

Tabela 31. Vjedh prej shtëpisë, shkollës ose gjetkë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	79	69.9	69.9	69.9

	Disi e vërtetë	16	14.2	14.2	84.1
	Tërësisht e vërtetë	18	15.9	15.9	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Lidhur me deklaratën “Kalon më mirë me të rriturit se me fëmijët e tjerë”, kuptojmë se 35.4% e respondentëve apo 40 thonë se nuk është e vërtetë; 42.5% e respondentëve apo 48 e shohin si disi të vërtetë dhe 22.1% e respondentëve apo 25 e shohin si tërësisht të vërtetë.

Tabela 32. Kalon më mirë me të rriturit se me fëmijët e tjerë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	40	35.4	35.4	35.4
	Disi e vërtetë	48	42.5	42.5	77.9
	Tërësisht e vërtetë	25	22.1	22.1	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Siç shihet nga rezultatet e deklaratës “Frikësohet lehtë”, kuptojmë se 37.2% e respondentëve apo 42 mendojnë se është jo të vërtetë; 38.9% e respondentëve apo 44 e shohin si disi të vërtetë dhe 23.9% e respondentëve apo 27 mendojnë se është tërësisht e vërtetë.

Tabela 33. Frikësohet lehtë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	42	37.2	37.2	37.2
	Disi e vërtetë	44	38.9	38.9	76.1
	Tërësisht e vërtetë	27	23.9	23.9	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Të pyetur për deklaratën “Ka vëmendje të plotë, ose përfundon detyrat deri në fund”, respondentët dhanë këto përgjigje: 35.4% e respondentëve apo 40 e shohin si jo të vërtetë; 30.1% e respondentëve apo 34 si disi të vërtetë dhe 34.5% e respondentëve apo 39 mendojnë se është tërësisht të vërtetë.

Tabela 34. Ka vëmendje të plotë, ose përfundon detyrat deri në fund

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Jo e vërtetë	40	35.4	35.4	35.4
	Disi e vërtetë	34	30.1	30.1	65.5
	Tërësisht e vërtetë	39	34.5	34.5	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Të pyetur se sa gjatë i ka pasur këto vështirësi respondentët kanë dhënë këto përgjigje: 14.2% prej tyre pohojnë se këto vështirësi i ka pasur për më pak se një muaj; 20.4% prej tyre pohojnë se këto vështirësi i ka pasur për 1-5 muaj; 28.3% prej tyre pohojnë se këto vështirësi i ka pasur për 6-12 muaj dhe 37.2% prej tyre pohojnë se këto vështirësi i ka pasur për mbi një vit. Sipas rezultateve, shumica statistikore qëndron në mendimin se këto vështirësi i kanë hasur te fëmija për më tepër se një vit.

Tabela 35. Sa gjatë i ka pasur këto vështirësi

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Më pak se një muaj	16	14.2	14.2	14.2
	1-5 muaj	23	20.4	20.4	34.5
	6-12 muaj	32	28.3	28.3	62.8
	Mbi një vit	42	37.2	37.2	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Respondentët të pyetur se a e mërzhisin apo e shqetësojnë vështirësitë atë, kanë dhënë këto përgjigje: 11.5% prej tyre pohojnë se këto vështirësi nuk e mërzhisin apo shqetësojnë atë aspak; 11.5% prej tyre pohojnë se këto vështirësi e mërzhisin apo shqetësojnë atë vetëm pak; 46.9% prej tyre pohojnë se këto vështirësi e mërzhisin apo shqetësojnë atë mesatarisht dhe 30.1% prej tyre pohojnë se këto vështirësi e mërzhisin apo shqetësojnë atë shumë. Sipas të dhënave duket se shkalla më e pohuar nga mësimdhënësit është mesatarisht, megjithatë një përqindje të lartë ka

edhe pohimi shumë. Pra, nga këto rezultate kuptojmë se vështirësitë emocionale e mërzhisin apo shqetësojnë fëmijën nga mesatarisht deri në masë të madhe.

Tabela 36. A e mërzhisin apo e shqetësojnë vështirësitë atë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	13	11.5	11.5	11.5
	Vetëm pak	13	11.5	11.5	23.0
	Mesatarisht	53	46.9	46.9	69.9
	Shumë	34	30.1	30.1	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga responentët është kërkuar të bëhet ndërlidhja e vështirësive me jetën e përditshme të fëmijës në raportet kolegiale, nga përgjigjet responentëve kemi këto rezultate: 11.5% prej tyre mendojnë se vështirësitë nuk bien ndesh aspak me jetën e përditshme në raportet kolegiale; 17.7% prej tyre mendojnë se vështirësitë bien ndesh vetëm pak me jetën e përditshme në raportet kolegiale; 50.4% prej tyre mendojnë se vështirësitë bien ndesh mesatarisht me jetën e përditshme në raportet kolegiale dhe 20.4% mendojnë se vështirësitë bien ndesh shumë me jetën e përditshme në raportet kolegiale. Sipas rezultateve, shumica statistikore qëndron në mendimin se këto vështirësi bien ndesh mesatarisht me jetën e përditshme në raportet kolegiale.

Tabela 37. Ndërlidhja e vështirësive me jetën e përditshme të fëmijës në raportet kolegiale

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	13	11.5	11.5	11.5
	Vetëm pak	20	17.7	17.7	29.2
	Mesatarisht	57	50.4	50.4	79.6
	Shumë	23	20.4	20.4	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Nga responentët është kërkuar të bëhet ndërlidhja e vështirësive me jetën e përditshme të fëmijës në të mësuarit në klasë, nga përgjigjet responentëve kemi këto rezultate: 9.7% prej tyre

mendojnë se vështirësitë nuk bien ndesh aspak me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë; 18.6% prej tyre mendojnë se vështirësitë bien ndesh vetëm pak me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë; 40.7% prej tyre mendojnë se vështirësitë bien ndesh mesatarisht me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë dhe 31% mendojnë se vështirësitë bien ndesh shumë me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë. Sipas rezultateve, shumica statistikore qëndron në mendimin se këto vështirësi bien ndesh mesatarisht me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë. Mund të pohojmë se këto rezultate nuk janë aspak të kënaqshme pasi që një përqindje e lartë pohojnë gjithashtu se këto vështirësi bien ndesh shumë me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë.

Tabela 38. Ndërlidhja e vështirësive me jetën e përditshme të fëmijës në të mësuarit në klasë

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	11	9.7	9.7	9.7
	Vetëm pak	21	18.6	18.6	28.3
	Mesatarisht	46	40.7	40.7	69.0
	Shumë	35	31.0	31.0	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Të pyetur se a i vënë ngarkesë këto vështirësi klasës në tërësi, respondentët kanë dhënë këto përgjigje: 5.3% prej tyre pohojnë se këto vështirësi nuk i vënë ngarkesës aspak klasës në tërësi; 11.5% prej tyre pohojnë se këto vështirësi i vënë vetëm pak ngarkesë klasës në tërësi; 40.7% prej tyre pohojnë se këto vështirësi vënë mesatarisht ngarkesë klasës në tërësi dhe 42.5% prej tyre pohojnë se këto vështirësi i vënë shumë ngarkesë klasës në tërësi. Sipas të dhënave duket se shkalla më e pohuar nga mësuesit është mesatarisht dhe shumë. Pra, nga këto rezultate kuptojmë se vështirësitë emocionale i vënë ngarkesë klasës në tërësi.

Tabela 39. A i vënë ngarkesë këto vështirësi klasës në tërësi

		Frequency	Percent	Valid Percent	Cumulative Percent
Valid	Aspak	6	5.3	5.3	5.3

	Vetëm pak	13	11.5	11.5	16.8
	Mesatarisht	46	40.7	40.7	57.5
	Shumë	48	42.5	42.5	100.0
	Total	113	100.0	100.0	

Testimi i hipotezave

Hipoteza është një pohim i testueshëm për marrëdhënien midis dy apo më shumë koncepteve që janë statistikisht të testueshme, është një supozim apo sqarim i cili pranohet përkohësisht për të interpretuar realitetin (Mathews & Ross, 2010).

Pra, qëllimi i hulumtimit tonë është që t'i testojë marrëdhëniet në fjalë, me qëllim të provojë apo hedh poshtë, vërtetësinë e hipotezave të parashtruara.

Në këtë hulumtim, hipotezat do të testohen duke përdorur Testin e korrelacionit Pearson, Testin H_i^2 , si dhe Testin Independent Sample Test.

Ky hulumtim ka tri hipoteza, dhe ato janë si vijojnë më poshtë:

H1 -Vështirësitë emocionale ndikojnë në masë të madhe në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e Komunës së Prizrenit.

H2- Mësimdhënësit nuk janë të përgatitur mjaftueshëm për njohuritë e vështirësive emocionale të fëmijëve të ciklit fillor.

H3-Gjinia femërore është më e prirë të ketë vështirësi emocionale, krahasuar me gjininë mashkullore.

Testimi i hipotezës së parë

Kësisoj është parashtruar pyetja e parë kërkimore: *Sa ndikojnë vështirësitë emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e ulëta të Komunës së Prizrenit?* Për të dhënë përgjigje në këtë pyetje është hartuar hipoteza, si më poshtë:

H1- *Vështirësitë emocionale ndikojnë në masë të madhe në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e Komunës së Prizrenit.*

Për të matur lidhjen në mes të vështirësive emocionale dhe arritjeve akademike të fëmijëve të ciklit fillor, është aplikuar testi i korrelacioneve të Pearsonit. Variabla e pavarur në këtë rast është mesatarja e pyetjeve që masin vështirësitë emocionale, respektivisht pyetjet B2, B3, B5, B6, B8, B10, B12, B13, B15, B16, B18, B19, B22 dhe B24, kurse variabla e varur është mesatarja e pyetjeve të pengesës në arritjet akademike, përkatësisht B15, B25, B32 dhe B31.

Tabela 40. Testi i korrelacionit Pearson për hipotezën e parë

<i>Correlations</i>		Vështirësitë emocionale	Pengesa në arritjet akademike
Vështirësitë emocionale	Pearson Correlation	1	0.191*
	Sig. (2-tailed)		0.043
	N		113
Pengesa në arritjet akademike	Pearson Correlation		1
	Sig. (2-tailed)		
	N		

*. Correlation is significant at the 0.05 level (2-tailed).

Në bazë të rezultateve të mësipërme shohim se kemi një lidhje signifikante në mes të vështirësive emocionale dhe pengesave në arritjet akademike ($r=0.191^*$, $p\text{-value}=0.043$), e cila është signifikante në 0.05 të margjinës së gabimit. Me këtë rast themi se sa më i madh niveli i vështirësive emocionale, aq më e madhe është pengesa në arritjet akademike të nxënësve. Në këtë mënyrë, pranohet hipoteza e parë e cila thotë se vështirësitë emocionale ndikojnë në masë të madhe në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e Komunës së Prizrenit.

Më poshtë është paraqitur edhe figura 1, ku është prezantuar lidhja në mes të vështirësive emocionale dhe pengesave në arritjet akademike.




Figura 1. Lidhja në mes të vështirësive emocionale dhe pengesave në arritjet akademike

Testimi i hipotezës së dytë

Pyetja e dytë kërkimore e këtij punimi është: *Sa janë të përgatitur mësimmhënësit për vështirësitë emocionale të fëmijëve të ciklit fillor?* Për të dhënë përgjigje në këtë pyetje është hartuar hipoteza si më poshtë:

H2- *Mësimmhënësit nuk janë të përgatitur mjaftueshëm për njohuritë e vështirësive emocionale të fëmijëve të ciklit fillor.*

Për të matur përgatitjen e mësimmhënësve në raport me njohuritë e vështirësive emocionale të fëmijëve të ciklit fillor, është aplikuar testi H_i^2 , ku është bërë krahasimi në mes mësimmhënësve meshkuj dhe femra opinioni i tyre në raport me katër pyetjet të cilat prekin njohuritë e tyre mbi vështirësitë emocionale.

Tabela 41. Testi H_i^2 për hipotezën e dytë

Gjinia – Chi-square / H_i^2	pearson		
	chi-square	df	p-value
A e mërzhisin apo shqetësojnë vështirësitë atë?	9.664	9	0.378
A bien ndesh vështirësitë me jetën e përditshme të fëmijës tuaj në raportet kolegjiale?	8.513	9	0.483
A bien ndesh vështirësitë me jetën e përditshme të fëmijës tuaj në të mësuarit në klasë?	11.228	9	0.260
A i vënë ngarkesë këto vështirësi klasës në tërësi?	12.092	9	0.208

Në bazë të rezultateve të mësipërme kuptojmë se në asnjërin prej rasteve nuk është gjetur ndonjë dallim signifikant sa i përket njohurive të mësimdhënësve mbi rastet kur fëmijët i mërzhisin apo shqetësojnë vështirësitë (chi-square=9.664, df=9, p-value=0.378), pastaj në rastin kur këto bien ndesh me vështirësitë me jetën e përditshme të fëmijës së tyre në raport kolegjial (chi-square=8.514, df=9, p-value=0.483). Gjithashtu edhe në rastin se këto bien ndesh me vështirësitë me jetën e përditshme të fëmijës së tyre në të mësuarit në klasë (chi-square=11.228, df=9, p-value=0.260) dhe se këto janë vënë ngarkesë dhe vështirësi klasës në tërësi (chi-square=12.092, df=9, p-value=0.208).

Me këtë kuptojmë se edhe mësimdhënësit meshkuj edhe femra kanë të njëjta mendime sa i përket nivelit të vështirësive dhe ndikimit që kanë këto tek arritjet e fëmijëve, pra niveli i njohurive të tyre në bazë të rezultateve të cilat shihen edhe me anë të figurave 2, 3, 4 dhe 5, janë në nivel të kënaqshëm.




Figura 2. Krahasimi gjinor në deklaratën “A e mërzhisin apo shqetësojnë vështirësitë atë?”




Figura 3. Krahasimi gjinor mbi ndikimin e vështirësive në raportet kolegiale




Figura 4. Krahasimi gjinor mbi ndikimin e vështirësive në të mësuarit në klasë




Figura 5. Krahasimi gjinor i mësuesve lidhur me ndikimin e vështirësive klasës në tërësi

Testimi i hipotezës së tretë

Lidhur me pyetjen e tretë kërkimore: *Cila gjini është më e prirë të ketë vështirësi emocionale?*, është hartuar hipoteza, si më poshtë:

H3-Gjinia femërore është më e prirë të ketë vështirësi emocionale, krahasuar me gjininë mashkullore

Për të matur dallimin në mes të nxënësve të gjinisë mashkullore dhe femërore në raport me nivelin e vështirësive emocionale, është aplikuar testi Independent Sample T-test. Variabla e pavarur në këtë rast është gjinia e nxënësve, kurse e varur është niveli mesatar i vështirësive të pyetjeve (B2, B3, B5, B6, B8, B10, B12, B13, B15, B16, B18, B19, B22 dhe B24).

Në bazë të rezultateve të prezantuara në tabelën 42 shohim se mesatarja e nivelit të vështirësive tek gjinia femërore është 1.90 me devijim standard prej 0.49, kurse tek meshkujt mesatarja është 1.85 një nivel më i ulët i vështirësive dhe devijim standard prej 0.47.

Tabela 42. Mesatarja e nivelit të vështirësive tek gjinia femërore dhe mashkullore

Group Statistics

	Gjinia e fëmijës	N	Mean	Std. Deviation	Std. Error Mean
Vështirësitë emocionale	Femër	69	1.9023	0.49037	0.05947
	Mashkull	44	1.8604	0.47379	0.07143

Nga të dhënat e tabelës 43 shohim se testi i rëndësisë statistikore $F=0.273$, testi $t=0.451$, shkallë lirie $df=110$ dhe $p\text{-value}=0.655$ e cila është më e madhe se 0.05 që nënkupton se pavarësisht dallimit në aspektin e mesatares, ajo vlerë nuk është statistikisht signifikante. Pra, mund të konkludojmë se nuk ka asnjë dallim statistikisht signifikant në mes të fëmijëve të gjinisë mashkullore dhe femërore në raport me vështirësitë emocionale, andaj e hedhim poshtë hipotezën e tretë.

Tabela 43. Testi i rëndësisë statistikore (Independent Sample Test) për hipotezën e tretë

Independent Samples Test

		Levene's Test for Equality of Variances		t-test for Equality of Means						
		F	Sig.	T	df	Sig. (2-tailed)	Mean Difference	Std. Error Difference	95% Confidence Interval of the Difference	
									Lower	Upper
Vështërsitë emocionale	Equal variances assumed	0.273	0.602	0.448	110	0.655	0.04192	0.09363	-0.14364	0.22748
	Equal variances not assumed			0.451	94.218	0.653	0.04192	0.09294	-0.14261	0.22645

Rezultatet e testimit të hipotezave

Duke u bazuar në rezultatet e testimit të hipotezave mund të përfundojmë se:

1. Sa më i madh të jetë niveli i vështirësive emocionale, aq më e madhe është pengesa në arritjet akademike të nxënësve. Pra, ndikimi i vështirësive emocionale është statistikiisht signifikant në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në shkollat e Komunës së Prizrenit.
2. Mësimdhënësit meshkuj dhe femra kanë të njëjtat mendime sa i përket nivelit të vështirësive dhe ndikimit që kanë këto tek arritjet akademike të fëmijëve, respektivisht niveli i njohurive të tyre në bazë të rezultateve të fituara është në nivel të kënaqshëm.
3. Nuk ekzistojnë dallime statistikiisht signifikante në mes të fëmijëve të gjinisë mashkullore dhe femërore në raport me vështirësitë emocionale.

V. DISKUTIMI DHE KONKLUDIMET

Kapitulli i fundit i këtij punimi përmban përmbledhje të tërësishme të të gjeturave të hulumtimit përfshirë edhe kufizimet e punimit, implikimet në të ardhmen dhe rekomandimet rrjedhëse të hulumtimit. Në fillim të kapitullit do të trajtohet në mënyrë të përmbledhur profili demografik i respondentëve, e pastaj do të trajtohen gjetjet e hulumtimit lidhur me qëllimet e hulumtimit. Marrë parasysh faktin që hulumtimet e kësaj fushe në vendin tonë janë numerikisht të pakta, bazuar edhe në synimin e hulumtimit që të sjellë një pasqyrë të ndikimit të këtyre vështirësive emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të moshës shkollore, konsideroj që ky punim do të sjell risi dhe një kontribut relativisht të madh për këtë fushë në vendin tonë. Gjithashtu rekomandimet që do të dalin nga ky punim, si pika referuese për hulumtimet me fokus të njëjtë apo të ngjashëm me temën në fjalë, do të jenë udhërrëfyese për stafin edukativo-arsimor si dhe për Drejtoritë Komunale të Arsimit lidhur me trajtimin adekuat të këtyre vështirësive.

Studimi ynë është një përpjekje modeste, në një mostër përfaqësuese të institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Prizrenit për të vërtetuar ndikimin që kanë vështirësitë emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të moshës shkollore.

Hulumtimi është kryer në dymbëdhjetë institucione edukativo-arsimore të Komunës së Prizrenit dhe ka pasur gjithsej njëqind e trembëdhjetë respondentë. Mostra është zgjedhur në mënyrë rastësore, ashtu që të kemi një përfaqësim të denjë të tyre në hulumtim.

Sa i përket klasifikimit të institucioneve edukativo-arsimore sipas lokacionit, 27.5% e respondentëve u takojnë shkollave nga lokacioni rural, kurse 72.5% e tyre u takojnë shkollave nga lokacioni urban.

Respondentë ishin mësimdhënës, të cilët iu përgjigjen pyetjeve lidhur me vështirësitë emocionale duke u bazuar te fëmijët që mendonin se hasin në këto vështirësi. Sa i përket moshës së fëmijëve, me përqindje më të lartë mbizotërojnë fëmijët e moshës 9 dhe 10 vjeç, përderisa përqindja më e vogël i takon moshës 6 vjeç. Sipas këtyre rezultateve, konstatoam se fëmijët e moshës 6 vjeçare janë më pak të prekur nga vështirësitë emocionale, ndërsa më shumë ata të moshës 9 dhe 10 vjeçare.

Nga të dhënat e fituara shihet se 85% e respondentëve janë femra dhe 15% e respondentëve janë meshkuj, duke paraqitur një realitet të gjendjes së strukturës gjinore të Republikës së Kosovës, pasi profesioni i mësimdhënësit në vendin tonë më së shumti synohet nga gjinia femërore.

Përqindja më e madhe e respondentëve 38.1%, u takon grup moshës 46-55 vjeç por me përqindje të lartë janë edhe grupmoshat 23-35 vjeç dhe 36-45 vjeç kurse përqindja më e ulët 8.8% u takon grup moshës mbi 56 vjeç.

Sa i përket shkollimit të respondentëve me një shumicë dërmuese dominon përgatitja profesionale e nivelit Bachelor (saktësisht 69.9%), përderisa vërehet edhe një përqindje e mësimdhënësve me përgatitje profesionale të Shkollës së Lartë (9.7%). Me përqindje më të ulët (saktësisht 3.5%) dominon përgatitja profesionale Doktoratë, e cila ndonëse e vogël në numër është e kënaqshme.

Sa i përket gjatësisë së kohës së punës në institucione, nga respondentët, 31% e respondentëve kanë përvojë pune mbi 20 vite, e kjo është shprehëdhënëse për hulumtimin tonë pasi do të marrim një vlerësim real të gjendjes në institucione edukativo-arsimore.

Qëllimi i këtij studimi shkencor ishte evidentimi i ndikimit të vështirësive emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, si dhe analizimi i raporteve mes këtyre vështirësive emocionale dhe arritjeve akademike, moshës dhe gjinisë, andaj në këtë pjesë do të reflektohen rezultatet e hulumtimit tonë.

Studimet kanë treguar se të rinjtë me probleme të shëndetit mendor kanë arritje më të ulëta akademike, krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre (McLeod, Uemura, & Rohrman, 2012), ndërsa (Arnold, 1997) dhe (Hinshaw, 1992) vërtetuan se vështirësitë emocionale janë të lidhura me vështirësitë akademike. Wetzal dhe Asher, më 1995, kanë demonstruar se aftësitë për rregullimin e emocioneve janë të lidhura ngushtë me arritjet akademike (Wentzel & Asher, 1995), e po ashtu janë duke u shtuar faktet se nxënësit me probleme emocionale marrin nota më të ulëta në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre që nuk shfaqin këto problematika (Wagner & Cameto, 2004). Ngjashëm me këto të gjetura ndërkombëtare, edhe ky studim gjeti se vështirësitë emocionale në mënyrë statistikisht signifikante ndikojnë në arritjet akademike të fëmijëve të

ciklit fillor, në shkollat e Komunës së Prizrenit, duke vërtetuar kështu hipotezën e parë dhe kryesore të punimit.

Nga respondentët është kërkuar të bëhet ndërlidhja e vështirësive me jetën e përditshme të fëmijës në të mësuarit në klasë dhe nga përgjigjet e respondentëve kuptojmë se përqindjet më të larta, 40.7% prej tyre mendojnë se vështirësitë bien ndesh mesatarisht me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë dhe 31% mendojnë se vështirësitë bien ndesh shumë me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë. Sipas rezultateve, shumica statistikore qëndron në mendimin se këto vështirësi bien ndesh mesatarisht me jetën e përditshme në të mësuarit në klasë. Këto të gjetura janë në përputhje me hulumtime të shumta ndërkombëtare, si ajo e (Cassady & Johnson, 2002) të cilët theksojnë se ankthi e pengon procesin e të nxënësit dhe ecurinë në test pasi nxënësit që janë shumë në ankth, në vend që të përqendrohen, ata vazhdojnë ta kenë mendjen të ngushtimi që ndjejnë në kraharor, pastaj me atë të (Goleman, 2018) i cili thekson se depresioni ua dëmton kujtesën dhe përqendrimin duke ua vështirësuar së tepërmi përthithjen dhe ngulitjen e informacionit, si dhe studimet e (Naveh-Benjamin; McKeachie & Lin, 1987) dhe (Zeidner, 1998) të cilët paraqesin rezultate që mbështesin ndikimin e ankthit si një disavantazh në organizimin e materialit dhe dështimit në shkollë.

Të pyetur se sa shpesh e humbet temperamentin (disponimin), 35.4% e respondentëve pohuan se është tërësisht e vërtetë, e po ashtu për deklaratën “Shumë shqetësime ose shpesh duket i shqetësuar”, kuptuam se 38.9% mendojnë se kjo është disi e vërtetë dhe 24.8% deklarojnë se është tërësisht e vërtetë që fëmijët kanë shumë shqetësime ose shpesh duken të shqetësuar. Këto të gjetura përputhen me studimin e (Morris & Maisto, 2008), të cilët theksojnë se tek fëmijët e moshës shkollë, depresioni mund të shfaqet si një sjellje antisociale, shqetësim i tepruar, shqetësime të gjumit apo si lodhje e papërligjur.

Gjinia përbën variablën më parashikuese në të gjitha grupet e studiuara. Gjinia femërore shoqërohet në mënyrë pozitive me vështirësitë emocionale. Në një studim që përbën një përmbledhje të plotë meta-analitike të dallimeve gjinore dhe moderatorëve të shprehjes së emocioneve nga foshnjëria deri në adoleshencë, konkludohet që vajzat shfaqin më shumë emocione pozitive dhe emocione të brendshme (p.sh., trishtim, ankth, simpati), sesa djemtë (Chaplin & Aldao, 2013). Ndonëse hulumtimi i (Fanaj & Melonashi, 2013), thekson që vajzat

posedojnë më shumë vështirësi emocionale, rezultatet e këtij studimi bien në kundërshtim me të gjeturat tona, kështu që refuzohet hipoteza e tretë e punimit, pasi që sipas analizave empirike nuk ekziston asnjë dallim statistikisht signifikant në mes të fëmijëve të gjinisë mashkullore dhe femërore në raport me vështirësitë emocionale.

Ndonëse nuk ishte në fokusin e hulumtimit, gjatë studimit tonë konstatuam se fëmijët e moshës 6 vjeçare janë më pak të prekur nga vështirësitë emocionale, kurse më të prekur nga këto vështirësi shihet moshë 9 dhe 10 vjeçare e fëmijëve.

Kufizimet e studimit

Gjatë kryerjes së hulumtimit, natyrisht që kam hasur në disa kufizime, të cilat në një mënyrë apo tjetër ndikuan në cilësinë e punimit, pra në arritjen e rezultateve më të vlefshme dhe të përgjithshme lidhur me temën e caktuar.

Kufizimi kryesor i këtij punimi është periudha gjatë të cilit është kryer hulumtimi. Për shkak të gjendjes pandemike, të përhapjes së virusit Covid-19, duke pasur parasysh masat mbrojtëse mësimdhënësit ishin duke punuar me grupe të vogla me nxënës. Rrjedhimisht, ata ishin të ngarkuar me punë shtesë në shkollë, por edhe të shqetësuar shpirtërisht, gjë që ndikoi edhe në ecurinë e procesit të mbledhjes së të dhënave, pasi një pjesë e madhe e tyre refuzuan plotësimin e pyetësorit. Gjithashtu, stresi në punë dhe gjendja emocionale mund të kenë pasur ndikim në përgjigjet e tyre.

Së dyti, një pjesë e madhe e pyetësorëve janë plotësuar pa praninë time. Për shkak të ngarkesave shtesë në shkollë, të sqaruara më lartë, mësimdhënësit i merrnin pyetësorët që ti plotësonin në shtëpi. Ky veprim paraqet kufizim për hulumtimin, pasi për disa pyetje mund t'u jenë dashur sqarime shtesë.

Së treti, si kufizim nuk duhet anashkaluar edhe hezitimin e mësimdhënësve për fëmijët me vështirësi emocionale. Ata vetëm pasi kuptonin, që nuk duhet deklaruar, të dhënat personale të fëmijës, deklarorin dhe plotësonin pa hezitim pyetjet lidhur drejtpërdrejtë për fëmijët që ata mendonin që hasin në vështirësi emocionale. Kjo lidhet ngushtë me qëndrimin dhe

bashkëpunimin prind-institucion, pasi një numër i konsiderueshëm i prindërve nuk pranojnë dhe refuzojnë faktin që fëmijët e tyre hasin në vështirësi emocionale.

Pas shqyrtimit të hollësishëm të literaturës si dhe pas hulumtimit të zhvilluar në institucionet edukativo-arsimore të Komunës së Prizrenit, me qëllim të identifikimit dhe trajtimit sa më efektiv të fëmijëve me vështirësi emocionale të ciklit fillor, nxjerrim këto rekomandime:

1. Mbajtja dhe organizimi i trajnimeve për mësime të mësimdhënësve me qëllim të identifikimit dhe trajtimit adekuat të fëmijëve me vështirësi emocionale.
2. Organizimi i mbledhjeve/trajnimeve me prindërit e nxënësve që mendojmë se hasin në vështirësi emocionale, me qëllim të njoftimit të tyre me mënyrën e trajtimit të fëmijëve të tillë edhe në shtëpi.
3. Organizimi i orëve shtesë për këta nxënës nga vet shkolla me një mësues të jashtëm ose trajner të certifikuar për trajtimin e këtyre vështirësive, duke u mësuar teknika relaksuese.
4. Fuqizimi i marrëdhënieve prind-mësues-drejtori, me qëllim të identifikimit dhe raportimit të gjendjes së këtyre fëmijëve.

Hulumtimet në të ardhmen

Ndonëse e punuar me përkushtim maksimal, çdo punim mund të sjell në vete edhe mangësi. Në mënyrë që mangësitë e këtij punimi të mos përsëriten edhe në hulumtimet tjera dhe ky të jetë hulumtim frytdhënës për shumë hulumtime tjera në të ardhmen, sugjeroj:

Në rast të përsëritjes së hulumtimit:

1. Të rritet numri i respondentëve pjesëmarrës në hulumtim.
2. Të kombinohet metoda sasiore me atë cilësore duke shtuar edhe intervista me fëmijë me vështirësi emocionale.

Në rast të realizimit të hulumtimeve të reja në këtë fushë:

1. Të analizohet ndikimi i vështirësive emocionale në fusha të tjera të jetës, përveç arritjeve akademike.
2. Të analizohet mënyra e trajtimit të fëmijëve me vështirësi emocionale nga mësuesit.
3. Të analizohet vështirësia emocionale, e cila është më e përhapur te fëmijët e moshës shkollore.

Implikimet praktike nga studimi

Ky studim pavarësisht kufizimeve e mangësive eventuale, është ndër studimet e pakta në këtë fushë, në vendin tonë, për të mos thënë ndër studimet e para. Prandaj, ky mund të ketë implikime praktike, për studiuesit, mësuesit si dhe institucionet edukativo-arsimore të vendit tonë në përgjithësi. Përmes këtij punimi konkluduar që vështirësitë emocionale ndikojnë në masë të madhe në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor, në Komunën e Prizrenit, e besojmë që një gjendje e tillë mbretëron me gjasa të mëdha edhe në komunat tjera. Pra, punimi mund të shërbejë si pikënisje për studiuesit për të reflektuar rreth këtij ndikimi të vështirësive emocionale.

Siç tregojnë gjetjet e punimit, moshën 9 dhe 10 vjeçare e fëmijëve shihet më e prekura nga vështirësitë emocionale. Shpesh frikërat dhe ankthet nuk shprehen por mbahen të kyçura brenda vetes duke u ndrojtur prej gjyqimit të tjerëve. Andaj mendoj se në të ardhmen mund të realizohen hulumtime që inkurajojnë fëmijët të flasin, shkruajnë, vizatojnë për frikërat e tyre, duke përbërë një faktor lehtësues për ta. Në fund, ky punim mund të shërbejë për ndërgjegjësim institucional ndaj pranisë së këtyre vështirësive emocionale në shkollat tona.

VI. BIBLIOGRAFIA

- Arnold, D. H. (1997). Co-occurrence of externalizing behavior problems and emergent academic difficulties in young high-risk boys: a preliminary evaluation of patterns and mechanisms. *Journal of Applied Developmental Psychology*, 18 (3), p. 317-330.
- Bosacki, S., & Moore, C. (2004). Preschoolers' understanding of simple and complex emotions: Links with gender and language. *Sex Roles*, 50, p. 659-675.
- Cassady, J. C., & Johnson, R. E. (2002). Cognitive test anxiety and academic performance. *Contemporary Educational Psychology*, 27(2), p. 270-295.
- Chaplin, T. M., & Aldao, A. (2013). Gender differences in emotion expression in children: a meta-analytic review. *Psychological bulletin*, 139 (4), p. 735–765.
- Charles, J., & Fazeli, M. (2017). Depression in children. *Australian family physician* , 46 (12), p. 901–907.
- Covington, M. V., & Omelich, C. L. (1987). "I knew it cold before the exam": A test of the anxiety-blockage hypothesis. *Journal of Educational Psychology*, 79(4), p. 393–400.
- Davitz, J. R. (1969). *Language of Emotion*. SPCK Publishing.
- Deng, Y., Chang, L., Yang, M., Huo, M., & Zhou, R. (2016). Gender differences in emotional response: Inconsistency between experience and expressivity. *PloS one*, 11(6), 1-12.
- Eisenberg, N., & Lennon, R. (1983). Sex differences in empathy and related capacities. *Psychological Bulletin*, 94(1), p. 100–131.
- Erdoğan, A. (2019). Çocuklarda mükemmeliyetçiliğin utanç ve suçluluk duygularını yordayıcılığı üzerine bir inceleme. *ProQuest Dissertations Publishing*.

- Fanaj, N., & Melonashi, E. (2013). Vështirësitë emocionale dhe arritjet akademike tek nxënësit e shkollave fillore në Prizren. *EDUCATIO*, p. 64-77.
- Fanaj, N., Melanoshi, E., & Shkëmbi, F. (2015). Self-esteem and hopelessness as predictors of emotional difficulties: A Cross-sectional study among adolescents in Kosovo. *Procedia - Social and Behavioral Sciences*, 165, 222-233.
- Fanaj, N., Poniku, I., Gashi, L., Vehbiu, B., & Morina, E. (2012). Hopelessness, self-esteem and other psychological characteristics of adolescents: Comparison between clinical cases and the community sample. *Neuropsychiatrie de l'Enfance et de l'Adolescence*, 60 (5), p. S130-S131.
- Forness, S. R., & Knitzer, J. (1992). A new proposed definition and terminology to replace "serious emotional disturbance" in Individuals with Disabilities Education Act. *School Psychology Review*, 21(1), p. 12–20.
- Freud, S. (1915). *The unconscious*. New York: Vintage.
- Frojd, Z. (2013). *Frika*. Shtëpia Botuese "Fan Noli".
- Furrer, C., & Skinner, E. (2003). Sense of relatedness as a factor in children's academic engagement and performance. *Journal of Educational Psychology*, 95 (1), p. 148–162.
- Gilbert, P. (2003). Evolution, Social Roles, and the Differences in Shame and Guilt. *The Johns Hopkins University Press*, 70 (4), p. 1205-1230.
- Goleman, D. (2018). *Inteligjenca Emocionale*. Prishtinë: Shtëpia Botuese "Pema".
- Goodman. (1997). The strengths and difficulties questionnaire: A research note. *Journal of Child Psychology and Psychiatry*, 38 (5), p. 581-586.
- Goodman, R., Ford, T., Simmons, H., Gatward, R., & Meltzer, H. (2000). Using the strengths and difficulties questionnaire (SDQ) to screen for child psychiatric disorders in a community sample. *The British Journal of Psychiatry*, 177, 534–539.

- Hinshaw, S. P. (1992). Externalizing behavior problems and academic underachievement in childhood and adolescence: Causal relationships and underlying mechanisms. *Psychological Bulletin*, 111 (1), p. 127-155.
- Izard, C. E. (1993). *Face of Emotion*. Irvington Pub.
- James, W. (1884). What is an emotion? *Mind*, 9(34), 188-205.
- Karadağ, M. (2020). Okulu bırakan ergenlerde depresyon ve anksiyete düzeylerinin değerlendirilmesi. *Klinik Psikiyatri Dergisi*, 23(3), p. 274-279.
- Kashani, J. H., Holcomb, W. R., & Orvaschel, H. (1986). Depression and depressive symptoms in preschool children from the general population. *The American journal of psychiatry*, 143 (9), p. 1138–1143.
- Lee, J., & Shute, V. J. (2010). Personal and social-contextual factors in K-12 academic performance: An integrative perspective on student learning. *Educational Psychologist*, 45(3), p. 185–202.
- Luby, J. L., Heffelfinger, A. K., Mrakotsky, C., Brown, K. M., Hessler, M. J., Wallis, J. M., & Spitznagel, E. L. (2003). The clinical picture of depression in preschool children. *Journal of the American Academy of Child and Adolescent Psychiatry*, 42 (3), p. 340–348.
- Mathews, B., & Ross, L. (2010). *Metodat e hulumtimit*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (CDE).
- McLeod, J. D., Uemura, R., & Rohrman, S. (2012). Adolescent mental health, behavior problems, and academic achievement. *Journal of Health and Social Behavior*, 53 (4), p. 482-497.
- Morris, C. G., & Maisto, A. A. (2008). *Understanding Psychology*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik.
- Mosher, D., & White, B. (1981). On differentiating shame and shyness. *Motivation and Emotion*, 5, p. 61-74.

- Narrow, W. E., Rae, D. S., Robins, L. N., & Rieger, D. A. (2002). Revised prevalence of mental disorders in the United States. *Archives of General Psychiatry*, 59, p. 115-123.
- Naveh-Benjamin, M. (1991). A comparison of training programs intended for different types of test-anxious students: Further support for an information-processing model. *Journal of Educational Psychology*, 83(1), p. 134–139.
- Naveh-Benjamin; McKeachie & Lin. (1987). Two types of test-anxious students: Support for an information processing model. *Journal of Educational Psychology*, 79(2), p. 131–136.
- Nushi, P. (2002). *Psikologjia e përgjithshme I*. Prishtinë: Libri shkollor.
- Ogundele, M. O. (2018). Behavioural and emotional disorders in childhood: A brief overview for paediatricians. *World Journal of Clinical Pediatrics*, 7 (1), p. 9-26.
- Orhani, Z. (2011). *Psikologjia e emocioneve*. Tiranë: Shtëpia botuese "Vllamasi".
- Poole, K. L., Cunningham, C. E., & Schmidt, L. A. (2020). Trajectories of Observed Shyness and Psychosocial Adjustment in Children. *Child psychiatry and human development*, 51 (4), p. 636–647.
- Powell, C. L., & Arriola, K. R. (2003). Relationship between psychosocial factors and academic achievement among African American students. *The Journal of Educational Research*, 96(3), p. 175–181.
- ProCon.org. (2020, July 12). *Standardized Tests*. Gjetur në ProCon.org: <https://standardizedtests.procon.org/>
- Şahin, M. (2019). Korku, kaygi ve kaygi (anksiyete) bozukluklari. *Avrasya Sosyal ve Ekonomi Araştırmaları Dergisi*, 6(10), p. 117-135.
- Simpson, J., & Weiner, E. (1989). *Oxford English Dictionary*. Oxford: Oxford University.
- Smits, J., O'Cleirigh, C., & Otto, M. (2006). Combining Cognitive-Behavioral Therapy and Pharmacotherapy for the Treatment of Panic Disorder. *Journal of Cognitive Psychotherapy*, 20, p.75-84.

- Tangney, J. P. (1995). Self-conscious emotions: The psychology of shame, guilt, embarrassment, and pride. Në J. P. Tangney, *Shame and guilt in interpersonal relationships* (fv. 114–139). New York: Guilford.
- Wagner, M., & Cameto, R. (2004). The characteristics, experiences, and outcomes of youth with emotional disturbances. *National Center on Secondary Education and Transition, 3*(2), 1-8.
- Ward, A., Stoker, H. W., & Murray-Ward, M. (1996). Achievement and ability tests-Definition of the domain. *Educational Measurement, 2*, 2-5.
- Wentzel, K. R., & Asher, S. R. (1995). The academic lives of neglected, rejected, popular, and controversial children. *Child Development, 66* (3), p. 756-763.
- Woolfolk, A. (2011). *Psikologji Edukimi*. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (CDE).
- You are Mom. (2018, July 27). *Factors that affect a child's academic performance*. Retrieved from You are Mom: <https://youaremom.com/parenting/children-academic-performance/>
- Zeidner, M. (1998). *Test anxiety: The state of the art*. New York: Plenum Press.

SHTOJCA: PYETËSORI

Të nderuar mësimdhënës,

Unë jam Ardora Haskuka, studente e nivelit Master në Fakultetin e Edukimit – drejtimi Edukim Inkluziv, të Universitetit “Hasan Prishtina” në Prishtinë. Në kuadër të punimit të diplomës me titull: *“Vështirësitë emocionale dhe arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor”*, së bashku me mentoren Prof. Ass. Dr. Ardita Devolli, kemi përgatitur këtë pyetësor me qëllim të mbledhjes së të dhënave të nevojshme për analizën empirike.

Ky studim shkencor ka për synim të evidentojë ndikimin e vështirësive emocionale në arritjet akademike të fëmijëve të ciklit fillor.

Pjesëmarrja juaj në këtë hulumtim është e mirëseardhur. Ju sigurojmë se përgjigjet tuaja do të jenë plotësisht konfidenciale dhe se të njëjtat do të shfrytëzohen vetëm në formë të agreguar statistikore, ashtu që asnjë informacion nuk do të jetë i identifikueshëm.

Pyetësori përbëhet nga dy pjesë përbërëse:

Pjesa A - TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

- Në këtë pjesë, përmes pyetësorit synohet të merret informacion i përgjithshëm për ju si respondent i këtij pyetësori, si dhe për ju si mësues i nxënësve me vështirësi emocionale.

Pjesa B - VËSHTIRËSITË EMOCIONALE

- Në këtë pjesë, përmes pyetësorit synohet të merret informacion për shkallën e paraqitjes së këtyre vështirësive te nxënësit, moshën në të cilën potencialisht paraqiten këto vështirësi, dhe natyrën e shfaqjes së këtyre vështirësive. Fillimi i kësaj pjese përmban 25 pyetje të klasifikuara në 5 nënshkallë të cilat matin emocionalitetin, hiperaktivitetin, problemet me moshatarët dhe sjelljet sociale. Gjithashtu nga katër nënshkallët e para mund të llogaritet edhe një variabël gjithëpërfshirëse e cila vlerëson vështirësitë në total.

JU FALEMINDERIT PARAPRAKISHT!

Pjesa A - TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

A.1. Emri i institucionit ku punoni:

A.2. Vendi

- 1) Fshat 2) Qytet

A.3. Moshë e fëmijës:

- 1) 6 vjeç
2) 7 vjeç
3) 8 vjeç
4) 9 vjeç
5) 10 vjeç
6) 11 vjeç

A.4. Gjinia e fëmijës?

- 1) Femër
2) Mashkull

A.5. Cilës moshë i përkisni?

- 1) 23-35
2) 36-45
3) 46- 55
4) Mbi 56

A.6. Gjinia juaj?

- 1) Femër
2) Mashkull

A.7. Niveli i shkollimit?

- 1) Shkollë e lartë
2) Bachelor
3) Master
4) Doktoratë

A.8. Përvoja e përgjithshme e viteve të punës në arsim?

- 1) Më pak se një vit
2) 1 – 10vite
3) 11-20 vite
4) Më shumë se 20 vite

Pjesa B - VËSHTIRËSITË EMOCIONALE

Për secilën nga pyetjet pasuese, ju lutem shënoni përgjigjën në njërin nga katrorët *Jo e vërtetë*, *Disi e vërtetë*, *Tërësisht e vërtetë*. Do të na ndihmojë nëse ju përgjigjeni të gjitha pyetjeve në mënyrën më të mirë që keni mundësi edhe nëse s'jeni tërësisht të sigurt. Ju lutem vendosni përgjigjet tuaja në bazë të sjelljes së nxënësit tuaj në gjashtë muajt e fundit ose këtë vit shkollor.

		Jo e vërtetë	Disi e vërtetë	Tërësisht e vërtetë
B.1	I merr në konsideratë ndjenjat e të tjerëve.			
B.2	Nervoz, tepër aktiv s'mund të qëndrojë në një vend për kohë të gjatë.			
B.3	Shpesh ankohet për kokëdhimbje, dhimbje barku ose për sëmundje.			
B.4	Me lehtësi i ndan me fëmijë të tjerë, p.sh. lojërat, ushqimin.			
B.5	Shpesh e humbet temperamentin (disponimin).			
B.6	Preferon më tepër të rri vet se me fëmijët tjerë.			
B.7	Në përgjithësi sillet mirë, zakonisht bën atë që ia kërkojnë të rriturit.			
B.8	Shumë shqetësime ose shpesh duket i shqetësuar.			
B.9	Dobishëm (ndihmues) nëse dikush lëndohet, mërzitet ose			

	ndjehet i sëmurrë.			
B.10	Vazhdimisht luhatet ose bën lëvizje nervozizmi.			
B.11	Ka së paku një shokë të mirë.			
B.12	Shpesh grindet me fëmijët tjerë ose i ngacmon ata.			
B.13	Shpesh është i trishtuar, i dëshpëruar ose i përlotur.			
B.14	Në përgjithësi, fëmijët tjerë e duan atë.			
B.15	Hutohet me lehtësi, humbet përqendrimin.			
B.16	Nervoz në situata të re, lehtë humbet besimin.			
B.17	I sjellshëm me fëmijët më të rinj.			
B.18	Shpesh gënjen ose mashtron.			
B.19	Bie në sy ose ngacmohet nga fëmijët tjerë.			
B.20	Shpesh u ofron ndihmë të tjerëve (prindërve, mësuesve, fëmijëve).			
B.21	I mendon gjërat para se të veprojë.			
B.22	Vjedh prej shtëpisë, shkollës ose gjetkë.			
B.23	Kalon më mirë me të rriturit se me fëmijët e tjerë.			
B.24	Frikësohet lehtë.			
B.25	Ka vëmendje të plotë, ose përfundon detyrat deri në fund.			

B.26. A keni ndonjë koment apo shqetësim tjetër ?

B.27. Në përgjithësi, a mendoni se ky nxënës ka vështirësi në një apo më tepër nga fushat e mëposhtme : emocionet, përqendrimi, sjellja ose të jetë në gjendje të shoqërohet me njerëzit e tjerë ? (Nëse “Po”, ju lutem përgjigjuni pyetjeve për këto vështirësi)

B.28. Sa gjatë i ka pasur këto vështirësi?

1) Më pak se një muaj 2) 1-5 muaj 3) 6-12 muaj 4) Mbi një vit

B.29. A e mërzhisin apo shqetësojnë vështirësitë atë?

1) Aspak 2) Vetëm pak 3) Mesatarisht 4) Shumë

B.30. A bien ndesh vështirësitë me jetën e përditshme të fëmijës tuaj në fushat e mëposhtme?

RAPORTET KOLEGIALE 1) Aspak 2) Vetëm pak 3) Mesatarisht 4) Shumë

TË MËSUARIT NË KLASË 1) Aspak 2) Vetëm pak 3) Mesatarisht 4) Shumë

B.31. A i vënë ngarkesë këto vështirësi klasës në tërësi?

1) Aspak 2) Vetëm pak 3) Mesatarisht 4) Shumë

Nënshkrimi: _____

Data: _____